

# Manual për vlerësimin ex-post të akteve juridike



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



**IFC**

International  
Finance Corporation  
WORLD BANK GROUP

# Manual

PËR VLERËSIMIN EX-POST TË AKTEVE JURIDIKE



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/145  
Datë: 07.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Manuali për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike në Republikën e Kosovës.
2. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe ministrisë e linjës për kryerjen e vlerësimeve *Ex-Post* të akteve juridike, sipas udhëzimeve të përcaktuara në Manual.
3. Në kuadër të planifikimit të rregullt vjetor të punës së Qeverisë, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit bashkërendon procesin e përgatitjes së Programit për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike në bashkëpunim me departamentet ligjore të ministrive.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit apo ministrisë përkatëse themelon grupin punues për realizimin e vlerësimit *Ex-Post* të aktit juridik, nga fusha e përgjegjësive të tyre administrative.
5. Të gjitha institucionet/njësitë përkatëse obligohen t'i ofrojnë mbështetje grupit punues në procesin e vlerësimit *Ex-Post*.
6. Pas shqyrtimit të draft raportit të vlerësimit *Ex-Post*, varësisht nga rekomandimi i tij, draft raporti procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të Qeverisë apo rikthehet te institucioni propozues për plotësim.
7. Rekomandimet e raportit të vlerësimit *Ex-Post* merren parasysh gjatë procesit të planifikimit dhe hartimit të akteve juridike.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për rishikimin dhe përditësimin e Manualit duke u bazuar në praktikat më të mira dhe përvojat e marra gjatë vlerësimeve *Ex-Post* të akteve juridike.
9. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që të bashkëpunojë me njësitë përgjegjëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në funksion të avancimit të metodologjisë së vlerësimit *Ex-Post* të akteve juridike në Kosovë dhe Shqyrtimit Post-Legjislativ.
10. Shtojcë e këtij vendimi është Manuali për Vlerësimin *Ex-Post* të Akteve Juridike.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 03/38 i datës 15 korrik 2015.

12. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

---

# PËRMBAJTJA

## 7 | SHKURTESAT

### SEKSIONI 1. HYRJE

- 10 | 1.1. Rreth këtij Manuali
- 10 | 1.2. Çfarë është Vlerësimi Ex-Post i Akteve Juridike Vlerësimi Ex-Post)?
- 13 | 1.3. Pse është i rëndësishëm Vlerësimi Ex-Post?
- 13 | 1.4. Sistemi Ex-Post në Kosovë

### SEKSIONI 2. PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT EX-POST

- 16 | 2.1. Përzgjedhja e aktit juridik që do të vlerësohet
- 18 | 2.2. Zgjedhja e fushës së vlerësimit

### SEKSIONI 3. HARTIMI/DIZAJNIMI I VLERËSIMIT EX-POST

- 20 | 3.1. HAPI 1: Zhvillimi i "zinxhirit të rezultateve"
- 22 | 3.2. HAPI 2: Zgjedhja e llojit të vlerësimit
- 25 | 3.3. HAPI 3: Përcaktimi i kriterëve dhe pyetjeve të vlerësimit
- 28 | 3.4. HAPI 4: Përcaktimi i treguesve të performancës
- 30 | 3.5. HAPI 5: Identifikimi i kërkesave të të dhënave / mbledhjes së të dhënave dhe metodave të konsultimit
- 31 | 3.6. HAPI 6: Përpunimi i "Matricës së Vlerësimit"

## SEKSIONI 4. KONSIDERATAT ORGANIZATIVE

- 34 | 4.1. Llojet e burimeve të kërkuara në vlerësim
- 35 | 4.2. Projektimi dhe ekzekutimi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm
- 36 | 4.3. Përgatitja e raportit të vlerësimit
- 37 | 4.4. Kontrolli i cilësisë
- 37 | 4.5. Shpërndarja dhe përdorimi i gjetjeve të vlerësimit

## SHTOJCAT

- 44 | Shtojca A.1. Rolet dhe përgjegjësitë për Vlerësimin Ex-Post-in në Kosovë
- 46 | Shtojca A.2. Si të zgjidhni objektin e vlerësimit (aktin juridik)
- 48 | Shtojca A.3. Analiza e palëve të interesuara për Vlerësimin Ex-Post
- 54 | Shtojca A.4. Llojet e vlerësimit
- 60 | Shtojca A.5. Metodatat e mbledhjes së të dhënave
- 63 | Shtojca A.6. "Matrica e vlerësimit"
- 64 | Shtojca A.7. Listat e kontrollit të cilësisë
- 65 | Shtojca A.8. Vlerësimi Ex-Post i ilustruar: "Ligji për shërbime këshilluese për zhvillimin rural"

## Shkurtesat

Për qëllime të këtij Manuali, shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

**Institucioni propozues**- Zyra e Kryeministrit ose ministritë e linjës që propozojnë, hartojnë dhe zbatojnë vlerësimin *ex-post*.

<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>RIA</b>	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
<b>RrPQ</b>	Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës
<b>PBB</b>	Prodhimit të Brendshëm Bruto
<b>ToR</b>	Termet e Referencës
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit (Qeveria e Republikës së Kosovës)
<b>ZL-ZKM</b>	Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit



---

## Parathënie

Gjatë viteve të fundit, Zyra e Kryeministrit dhe ministrinë kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përmirësuar planifikimin dhe përgatitjen e propozimeve legjislative, nëpërmjet angazhimit më gjithëpërfshirës të palëve të interesuara dhe hartimit të koncept dokumenteve në mënyrë më sistematike.

Megjithatë, legjislacioni arrin objektivat e synuara, vetëm nëse sigurohet edhe zbatimi i tij. Prandaj, është e rëndësishme që të monitorohet procesi i zbatimit të legjislacionit dhe rrjedhimisht të sigurohet përmbushja e qëllimeve të synuara. Kjo përbën objektivin kryesor në kuadër të përpjekjeve të Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në kryerjen e reformave ligjore.

Në këtë drejtim, tash e disa vite Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit dhe ministrinë angazhohen në kryerjen e vlerësimit të zbatimit të legjislacionit. Në këtë aspekt, Vendimi i Qeverisë 03/38 i vitit 2015 përmes miratimit të Manualit për Verësimin Ex-Post të Legjislacionit, për herë të parë në Kosovë i ka vendosur bazat e realizimit të Vlerësimit Ex-post të Legjislacionit.

Në rrjedhë të miratimit të manualit dhe përpjekjeve të Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve përmes organizimit të trajnimeve dhe përmirësimit të praktikave në kryerjen e këtyre vlerësimeve, ministrinë e linjës kanë fituar përvojë dhe ekspertizë në fushën e vlerësimit ex-post të legjislacionit.

Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të metodologjisë së kryerjes së vlerësimeve ex-post të akteve juridike, është hartuar ky Manual i cili përditësohet më tej me praktikën më të fundit ndërkombëtare të vlerësimit ex-post të legjislacionit. Qëllimi kryesor i këtij Manuali është thjeshtimi i udhëzimeve që kontribuojnë në realizimin e vlerësimit Ex-Post. Pra, në pak fjalë, Manuali ka për qëllim të jetë praktik, i lehtë për t'u konsultuar dhe përdorur, por njëkohësisht të ofrojë detaje të hollësishme për realizimin e vlerësimit Ex-Post, duke ofruar lista kontrolli, shabllone dhe shembuj praktikë për të udhëzuar kryerjen e këtij vlerësimi.

Tutje, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit ka parasysh se ky Manual është vetëm një nga hapat e rrugëtimit të gjatë drejt hartimit të raporteve më gjithëpërfshirëse dhe relevante të vlerësimit Ex-post. Për të arritur këtë qëllim, konceptet dhe mjetet e manualit që mbështesin vlerësimin Ex-Post duhet të përvetësohen nga të gjithë zyrtarët përgjegjës që marrin pjesë në procesin e këtyre vlerësimeve.

Për këtë arsye, realizimi i reformave në fushën ligjore është një përgjegjësi e përbashkët e administratës shtetërore që i kontribuon përmirësimit të procesit të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit. Prandaj, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit inkurajon të gjithë akterët e përfshirë në procesin e kryerjes së vlerësimit Ex-Post që të përdorin këtë Manual, duke i kushtuar rëndësi të veçantë planifikimit të kohës dhe burimeve të nevojshme për realizimin e procesit të këtyre vlerësimeve.

Për më tepër, duke pasur parasysh ndikimin e gjerë të legjislacionit, njëherit duke i kushtuar rëndësi reflektimit të publikut rreth zbatimit të legjislacionit dhe hapësirave për përmirësim të mëtejshëm të tij, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit inkurajon institucionet që në procesin e kryerjes së vlerësime Ex-Post të akteve juridike të bashkëpunojnë ngushtësisht me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit, siç përcaktohet nga ky Manual.

Krejt në fund, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit mbetet e përkushtuar që në bashkëpunim me institucionet e tjera të vazhdojë realizimin e reformave që i kontribuojnë avancimit të agjendës së Qeverisë për Rregullim më të Mirë, ndër të tjerash përmes fuqizimit të kapaciteteve të administratës shtetërore dhe më gjerë, si dhe shkëmbimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e vlerësimit Ex-Post të akteve juridike.

Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit falënderon partnerët ndërkombëtarë (veçanërisht Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore në partneritet me Konfederatën Zvicerane, respektivisht Sekretariatën Shtetërore për Çështjet Ekonomike – SECO dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë) dhe të gjithë ekspertët që kanë kontribuar aktivisht në hartimin e këtij Manuali.

Dr. Sc. Mentor Borovci  
Drejtor i Zyrës Ligjore, Zyra e Kryeministrit

---

## Pjesa 1: Hyrje

## 1.1. Rreth Manualit

Ky manual i shërben realizimit të Vlerësimit Ex-post të Akteve Juridike (“Vlerësimi Ex-Post”) në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Vlerësimi Ex-Post është proces objektiv i të kuptuarit se si është zbatuar një “akt juridik,” çfarë efektësh ka pasur, për kë dhe pse.

Manuali është i ndarë në pesë pjesë, të cilat përfshijnë hapat kryesorë mbi të cilët bazohet realizimi i vlerësimit Ex-Post. Këto pjesë janë:

- Hyrja:** prezanton Vlerësimin Ex-Post dhe përshkruan përfitimet e vlerësimit të duhur Ex-Post. Kjo pjesë përshkruan gjithashtu bazën ligjore për realizimin e Vlerësimit Ex-Post në Kosovë.
- Planifikimi për vlerësim:** ofron udhëzime në lidhje me përzgjedhjen e aktit juridik të cilit do t’i bëhet vlerësimi Ex-Post, si dhe përcakton fushëveprimin e këtij vlerësimi.
- Hartimi/Dizajni i vlerësimit:** përshkruan metodologjinë për të kryer një vlerësim Ex-Post në mënyrë më të detajuar dhe shpjegon se si të plotësohet modeli i raportit të vlerësimit. Kjo pjesë përmban gjashtë hapa që çdo vlerësues duhet të ndjekë përpara se të realizojë vlerësimin Ex-Post.
- Konsideratat organizative:** ofron informacion mbi implikimet praktike të realizimit të një vlerësimi Ex-Post, nga koha dhe burimet e kërkuara deri te sigurimi i kontrollit të cilësisë dhe shpërndarja efektive e gjetjeve të vlerësimit.
- Forma standarde e raportit të vlerësimit:** Së fundmi, Manuali përmban formën standarde të raportit të vlerësimit Ex-Post, duke përmbledhur elementet kryesore që duhet të përfshihen në pjesët e ndryshme të raportit.

Tutje, ky manual përmban 8 Shtojca të cilat janë pjesë përbërëse e tij dhe japin udhëzime shtesë rreth kryerjes së vlerësimeve Ex-Post, ndërsa vlen të theksohet se Shtojca A.8 në fund të Manualit, ofron një shembull praktik të logjikës që duhet ndjekur gjatë realizimit të një Ex-Post-i.

Manuali është hartuar konform praktikave më të mira ndërkombëtare. Për udhëzime më teknike ose të detajuara për kryerjen e hapave specifike analitike, çdo pjesë e këtij manuali ofron referenca në burime plotësuese.

## 1.2. Çfarë është Vlerësimi Ex-Post i Akteve Juridike?

Vlerësimi Ex-Post i akteve juridike nënkupton vlerësimin sistematik dhe të plotë të aktit juridik i cili përfshin (por nuk kufizohet në) përshtatshmërinë (relevancën), koherencën, efektivitetin, efikasitetin dhe/ose ndikimin e tij. Vlerësimi *ex-post* kryhet gjithashtu për të kontrolluar pajtueshmërinë, respektivisht përmbushjen e detyrimeve që derivojnë nga akti që i nënshtrohet vlerësimit *ex-post*. Prandaj, vlerësimi *ex-post* krijon një pasqyrë faktike dhe objektive të gjendjes aktuale të zbatimit të një akti juridik.

Vlerësimi quhet “*Ex-Post*”<sup>1</sup> sepse kryhet pas kalimit të një periudhe të caktuar të zbatimit të aktit juridik (shih Figurën 1.).<sup>2</sup>

“*Akti juridik*” i referohet *objektit të vlerësimit*. Mund të jetë një ligj (apo ligjet në një sektor), akt nënligjor ose disa nga dispozitatat e tyre.

<sup>1</sup> Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR), i cili haset në Koncept Dokumentin, shpesh referohet si vlerësim “*ex-ante*”, për të treguar se ajo analizë është kryer para miratimit të ndërhyrjes. VNR-ja mbulon fazat përgatitore dhe përpunuese të ciklit legjislativ.

<sup>2</sup> Figura 1. tregon se vlerësimi ndryshon nga vëzhgimi i rregullt, megjithëse ky i fundit është një parakusht i rëndësishëm për vlerësim. Ndërsa vlerësimi ofron një analizë të çastit në një moment të caktuar kohor, vëzhgimi është procesi i vazhdueshëm që përcjell atë që po ndodh gjatë zbatimit të politikave në mënyrë të vazhdueshme.

Ex post  
vlerësimi

RIA/Koncept  
dokumenti




Figura 1. Vendosja e vlerësimit ex-post në ciklin legjislativ

Përmes vlerësimit *ex-post* shqyrtohet dhe vlerësohet përshtatshmëria (relevanca), efektiviteti, efikasiteti i dispozitave juridike, pas kalimit të një periudhe të caktuar të zbatimit të tyre, koherenca e këtyre dispozitave me aktet e tjera si dhe me normat dhe standardet përkatëse ndërkombëtare.

Më konkretisht, ekzistojnë tri (3) lloje të mundshme të Vlerësimit *ex-post* - shih Rutinë 1.



## Kutia 1. Llojet e Vlerësimit Ex-Post

Vlerësuesi mund t'i kryejë tri (3) lloje vlerësimesh, në varësi të nevojave dhe burimeve që i ka në dispozicion, si dhe nga qëllimi i përgjithshëm i kryerjes së vlerësimit.

- **Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë:** Ky lloj vlerësimi synon të vlerësojë nëse akti juridik është duke u zbatuar siç është parashikuar, mat shkallën në të cilën procesi i zbatimit po realizohet, nëse zbatimi po realizohet në mënyrë të duhur ose jo, dhe pse. Ky lloj vlerësimi mundëson identifikimin dhe kuptimin e faktorëve që kanë ndihmuar ose penguar zbatimin e aktit juridik. Gjetjet nga ky lloj vlerësimi janë të rëndësishme për të kuptuar, për shembull, nëse burimet janë të mjaftueshme për të mbështetur procesin e zbatimit të aktit juridik, ose nëse palët subjekt i aktit juridik kanë vepruar konform tij. Mirëpo, duhet pasur parasysh se Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë nuk mund të përcaktojë nëse një kornizë ligjore “i ka arritur objektivat e saj të synuara” - kjo mund të vërtetohet përmes Vlerësimit të Performancës dhe Ndikimit (shih më poshtë).
- **Vlerësimi i Performancës:** Ky lloj vlerësimi synon të vlerësojë nëse ka pasur një marrëdhënie ndërmjet aktit juridik (ndërhyrjes) dhe efekteve që ka synuar të gjenerojë. Këto të fundit mund të jenë pasojat e menjëhershme (p.sh. hapat që palët e interesuara kanë ndërmarrë për të përmbushur një kërkesë ligjore) dhe pasojat afatgjate ekonomike, sociale dhe mjedisore. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që fillimisht të hartohet e ashtuquajtura “gënjehuri i rezultateve” (shih pjesën 3 më poshtë).
- **Vlerësimi i Ndikimit:** Qëllimi kryesor i këtij lloj vlerësimi është të krijojë një lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë shkakësore midis aktit juridik dhe efekteve të vëzhguara. Për këtë qëllim, ky lloj i vlerësimit duhet të mbështetet në analiza kundërfaktuale (d.m.th. analiza krahasuese ndërmjet grupit të kontrollit dhe trajtimit)<sup>3</sup>. Meqenëse kjo lloj analize është e vështirë të realizohet për një akt juridik (dispozitat ligjore zbatohen për të gjitha subjektet), ka më pak hapësirë për të aplikuar për akte juridike.

Shih **Shtojcën A.4.** për më shumë detaje mbi llojet e vlerësimit.

*Duhet pasur parasysh se këto lloje vlerësimi janë të njëpasnjëshme, kjo do të thotë që së pari duhet të kryhet një “Vlerësim i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë”, përpara se të fillohet një “Vlerësim i Performancës” ose një “Vlerësim Ndikimi”.* Hapi i parë duhet të jetë gjithmonë përcaktimi i niveleve të zbatimit dhe përputhshmërisë të aktit juridik. Nëse Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë dëshmon se akti juridik nuk është zbatuar, kjo do të thotë se çdo ndikim i identifikuar pas miratimit të tij nuk ka rrjedhur nga akti juridik por nga rrethanat tjera të cilat nuk ndërlidhen me aktin juridik.

*Duhet theksuar gjithashtu se analiza për një Vlerësim Ex-Post mund të dallojë sa i përket shtrirjes dhe thellësisë së saj, duke u bazuar në këto konsiderata:*

- Konstatimin, pas vlerësimit fillestar, se akti juridik nuk është zbatuar, ose është zbatuar vetëm pjesërisht, ose në mënyrë jo të duhur. Kjo “e detyron” vlerësuesin të kufizojë konsideratat e tij në procesin e zbatimit dhe jo të kalojë në vlerësim të efekteve; ose
- Edhe nëse akti juridik është zbatuar dhe ka sjellë efekte, vlerësuesi megjithatë mund t'a kufizojë vlerësimin vetëm në disa elemente të caktuara. Në këtë rast institucioni propozues, gjatë kryerjes së vlerësimit përcakton paraprakisht fushëveprimin e vlerësimit, për shembull:

- vetëm për disa efekte specifike (p.sh. barra administrative për bizneset) ose efekte të caktuara (efekti i aktit juridik vetëm për një grup të caktuar dhe jo për të gjitha grupet), apo
- vetëm për një lloj specifik të ndikimit (p.sh. efektet e ligjit në investimet e huaja, në rritjen e eksportit, ose në promovimin e barazisë gjinore).

## 1.3. Pse është i rëndësishëm Vlerësimi Ex-Post?

Vlerësimi Ex-Post ndihmon institucionet që:

- Të përcaktojnë nëse ka pasur zbatim në kohë, të plotë dhe të duhur të aktit juridik;
- Të identifikojnë se çfarë efektesh afatshkurtra dhe afatgjata kanë ndodhur nga zbatimi, duke ndikuar në kë, si dhe pse, dhe
- Të vlerësojnë nëse janë arritur objektivat e aktit juridik dhe me çfarë kostoje janë arritur të njëjtat.

Vlerësimi *Ex-Post* mund të përmbajë rekomandime të përgjithshme për veprime korrigjuese në lidhje me aktin e vlerësuar. Megjithatë, në parim, një vlerësim *Ex-Post* nuk përshkruan në detaje një ndërhyrje specifike ligjore që duhet të ndërmerret për të adresuar problemet ose boshllëqet e identifikuara në aktin juridik, sepse kjo e fundit është objektiv i procesit të vlerësimit të ndikimit ex-ante (Koncept Dokumenti), i cili synon të arrijë në opsionet më të mira që rrjedhin nga gjetjet e Vlerësimit *Ex-Post*.

Megjithatë, kryerja e Vlerësimit *Ex-Post* padyshim rezulton në shumë përfitime për institucionet, si: (1) përmirësimin e vendimmarrjes të bazuar në prova; (2) promovimin e pjesëmarrjes; (3) përparësinë e planifikimit dhe racionalizimit të burimeve; (4) nxitjen e zbatimit të politikave dhe (5) rritjen e efektivitetit, proporcionalitetit, besueshmërisë dhe legjitimitetit të institucioneve.

## 1.4. Sistemi i Vlerësimit Ex-Post në Kosovë

Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit dhe realizimi i efekteve të synuara të tij në masë të konsiderueshme ndihmohet, përveç tjerash, edhe nga kryerja e vazhdueshme e vlerësimeve ex-post. Për këtë arsye, në Strategjinë për Rregullim më të Mirë për Kosovën, dhe Vendimin e Qeverisë nr. 03/189 datë 23 maj 2014, Qeveria e Kosovës është zotuar që të zhvillojë vlerësimin ex-post si një mjet të rregullimit më të mirë.

Gjithsesi, institucionet duhet t'i njohin kërkesat e mësipërme para se ta fillojnë vlerësimin Ex-Post. Në këtë drejtim, Shtojca A.1. detajon detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve në Kosovë për kryerjen e vlerësimit Ex-Post, që rezultojnë nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e këtij Manuali.

<sup>3</sup> Grupi i trajtimit është grupi që i nënshtrohet dispozitave të aktit ligjor, ndërsa grupi i kontrollit jo.



---

## Pjesa 2: Planifikimi i vlerësimit Ex-Post



Përgatitja dhe planifikimi është e rëndësishme përpara se të realizohet një vlerësim Ex-Post. Në këtë kontekst, “Plani i Vlerësimit” është si një busullë që drejton organizimin e të gjitha aktiviteteve të vlerësimit Ex-Post. Një plan i mirë vlerësimi ndihmon në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi nga hartimi, koordinimi, realizimi dhe shpërndarja e gjetjeve të vlerësimit.

**Plani i Vlerësimit** përfshin organizimin e të gjitha aktiviteteve të vlerësimit. Një plan i mirë vlerësimi ndihmon ndarjen e roleve dhe përgjegjësi duke filluar nga procesi i hartimit, koordinimit, ekzekutimit, miratimit dhe publikimit të vlerësimit.

Ky kapitull paraqet zhvillimin dhe krijimin e strukturës së një Plani të Vlerësimit, dhe është i ndarë në dy pjesë kryesore:

1. Si të përzgjedhet akti juridik që duhet t’i nënshtrohet vlerësimit, dhe
2. Si të përkufizohet fushëveprimi i vlerësimit *Ex-Post*.

## 2.1. Përzgjedhja e aktit juridik që do t’i nënshtrohet vlerësimit

Institucioni propozues identifikon aktin juridik që duhet t’i nënshtrohet vlerësimit. Megjithatë, vlerësimi *Ex-Post* nuk kërkohet për të gjitha aktet juridike. Institucioni propozues duhet të arsyetojë se përse një akt juridik është përzgjedhur për vlerësim *Ex-Post*.

Përzgjedhja e aktit juridik mund të jetë vullnetare (me propozimin e institucionit propozues dhe përfshirjen e tij në Programin për Vlerësimin *Ex-Post*) ose e detyrueshme (me akt juridik, përmes një “dispozite vlerësimi ose rishikimi”), siç ilustron në figurën 2.

**Koha e realizimit të vlerësimit *Ex-Post* është një faktor i rëndësishëm.** Si rregull i përgjithshëm, **realizimi i Vlerësimit të Zbatimit dhe Pajtushmërisë si dhe Vlerësimi i Performancës duhet të mos realizohet para një viti** pas hyrjes në fuqi të aktit juridik. Ndërsa, Vlerësimi i Ndikimit duhet të fillojë në parim **jo më herët se tre vjet** pas hyrjes në fuqi të aktit juridik. Afatet e përcaktuara në dispozita të rishikimit nga akti juridik janë të detyrueshme dhe duhet të respektohen. **Shtojca A.2.** ofron më shumë detaje mbi procesin e përzgjedhjes së akteve juridike për vlerësim *Ex-Post*.

Figura 2. Përzgjedhja e aktit juridik

Përzgjedhja e aktit juridik bëhet në bazë të vlerësimit nga Institucioni propozues, përmes një apo më shumë **shqyrtimeve të mundshme** si në vijim.

Vlerësimi është i **detyrueshëm në bazë të kërkesave të qarta ligjore** në vetë aktin juridik (“dispozita ose klauzola e rishikimit”). Këto janë raste specifike. Dispozita të tilla rishikimi mund të tregojnë fushëveprimin e vlerësimit dhe qëllimin e tij; kohën kur duhet të kryhet një vlerësim i tillë; dhe detyrimin për të marrë në konsideratë gjetjet e vlerësimit dhe eventualisht për të rishikuar ose shfuqizuar dispozitat ligjore.

1

Akti juridik është instrumenti kryesor i realizimit të prioriteteve qeveritare dhe objektivave strategjike. Vlerësimi ex-post i aktit juridik mund të iniciohet edhe nga nevoja e Qeverisë për t’a vlerësuar ndikimin që kanë pasur objektivat strategjike dhe prioritetet e saj në lidhje me një sektor të caktuar apo të tërë politikës përkatëse të përcaktuar me aktin juridik.

2

Akti juridik ka ndikim të rëndësishëm në ekonomi, shoqëri, mjedis, sektorin publik dhe privat – kjo lidhet si me peshën e ndikimeve (p.sh. madhësinë e sektorit ekonomik të shprehur në përqindje të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) ose numrin e bizneseve të prekura, ose shumën e fondeve publike të investuara) ashtu edhe me kompleksitetin e dinamikave të nxitura nga ndërhyrjet ligjore (p.sh. lloji dhe numri i shtrirjeve të efektit të rezultateve). Në parim, sa më të rëndësishme të jenë ndikimet në fushat e mësipërme, aq më i lartë është prioriteti për vlerësim. Rëndësia e një akti juridik mund të vlerësohet edhe nga ajo që është përcaktuar në objektivat e tij dhe buxhetin e ndarë për zbatimin e tij. Nëse janë në dispozicion, koncept dokumentet përkatëse mund të ndihmojnë në identifikimin e llojeve të ndikimit.

3

Arsye tjetër për përzgjedhjen e një akti juridik mund të jetë identifikimi i ngecjeve dhe vështirësive në procesin e zbatimit. Një informacion i tillë mund të vijë nga njoftimet nga autoritetet zbatuese, ose nga reagimet e drejtpërdrejta nga palët e interesuara. Natyrisht, jo të gjitha sugjerimet për vlerësim janë të rëndësishme ose të arsyetuara: çdo organ propozues ka përgjegjësinë t’i shqyrtojë propozimet dhe të vendosë nëse do të fillojë një vlerësim dhe çfarë fushëveprimi do të ketë vlerësimi në fjalë.



## 2.2. Zgjedhja e fushëveprimit të vlerësimit Ex-Post të aktit juridik

Përzgjedhja e fushëveprimit të Vlerësimit *Ex-Post* të aktit juridik është element kritik për t'u pasur parasysh në këtë fazë.

Fushëveprimi i mundshëm i vlerësimit *Ex-Post* mund të jetë një akt juridik i vetëm, i përcaktuar mirë me objektiva të qarta dhe një numër të kufizuar palësh të prekura, ose mund të jenë më shumë akte juridike që janë pjesë e një politike gjithëpërfshirëse.

Për të njëjtin akt juridik mund të kryhen më shumë se një Vlerësim *Ex-Post*, nëse akti i tillë i trajton disa çështje të ndryshme dhe synon të arrijë objektiva të ndryshme. Për shembull, ligji përkatës për ekzekutimin e sanksioneve penale mund të përmbajë dispozita që kanë të bëjnë me masat e sigurisë së burgjeve dhe standardet për mbajtjen dhe paraburgimin e të burgosurve, dhe dispozitat për nxitjen e ri-integrimit social të të burgosurve pas lirim të tyre nga burgju. Këto janë objektiva të ndryshme, arritja e të cilave kërkon procese të veçanta zbatuese dhe përfshirje të llojeve të ndryshme të palëve të cilat përballen me sfida të ndryshme. Një institucion propozues duhet t'a marrë në konsideratë vlerësimin e këtyre aspekteve veç e veç, edhe pse janë pjesë përbërëse e të njëjtit akt juridik.

Tutje, institucioni propozues përcakton fushëveprimin e vlerësimit *Ex-Post* të aktit juridik, nëse është e nevojshme në konsultim me palët kryesore të përfshira (si ZKM), për të siguruar koherencë ndërmjet të gjitha vlerësimeve *Ex-Post* të kryera nga Qeveria. Është shumë e rëndësishme që të arsyetohet se si është përcaktuar fushëveprimi i vlerësimit *Ex-Post* dhe pse është zgjedhur fushëveprimi i caktuar.

Niveli i angazhimit (në burime dhe kohë) në procesin e Vlerësimit *Ex-Post* duhet të jetë në proporcion me objektivat e vlerësimit.

Fushëveprimi i një vlerësimi *Ex-Post* përcakton se cilat çështje ose tema trajtohen ose merren në konsideratë gjatë kryerjes së vlerësimit (p.sh. afati kohor, llojet e ndërhyrjeve, grupet e synuara, llojet e ndikimeve, fondet dhe aspekte të tjera). Përkufizimi i fushës së veprimit përcakton edhe nëse vlerësimi duhet t'i referohet një aktit juridik në tërësi (duke përfshirë aktet nënligjore e tij); ose vetëm dispozitave të zgjedhura të aktit juridik; ose disa akteve juridike që i përkasin të njëjtës politikë apo sektorit të caktuar.

# Pjesa 3: Hartimi/Dizajnimi i vlerësimit *Ex-Post*



Pasi të jetë vendosur se çfarë do të vlerësohet dhe pse, fillon hartimi ose dizajnimi i vlerësimit *Ex-Post*. Kjo pjesë përbëhet nga gjashtë hapa:

1. Zhvillimi i “zinxhirit të rezultateve”;
2. Zgjedhja e llojit të vlerësimit;
3. Përcaktimi i kritereve dhe pyetjeve të vlerësimit;
4. Përcaktimi i treguesve të performancës;
5. Identifikimi i kërkesave për të dhëna;
6. Përpunimi i “Matricës së Vlerësimit”.

### 3.1. HAPI 1: Zhvillimi i “zinxhirit të rezultateve”

Çdo veprim i Qeverisë (dhe si rrjedhojë edhe akti juridik që është në vlerësim) krijon ndryshime në sjellje dhe pasoja, të cilat duhet të çojnë në ndikimin e dëshiruar: zbutjen e një problemi shoqëror ose arritjen e një objekti të caktuar të politikës. Për t’i identifikuar ndryshimet dhe pasojat e tilla, është e nevojshme të formulohen **marrëdhëniet shkakore (shkak-pasojë)** që e lidhin analizën fillestare të situatës (problemin që akti juridik e trajton) me rezultatet e pritshme që mund të realizohen me zbatimin e aktit juridik, e cila kontribuon në arritjen e ndikimit (objektivave) përfundimtar. Një analizë e tillë quhet **Modeli i “zinxhirit të rezultateve”** (ose “logjikës së ndërhyrjes”).

Një **zinxhir rezultati** e vendos “logjikën shkakore” të ndryshimeve që nga zbatimi i aktit juridik, duke filluar nga burimet në dispozicion për zbatim të aktit, deri në arritjen e qëllimeve përfundimtare. Me të përcaktohet një sekuencë logjike që lidh inputet, aktivitetet dhe produktet me ndikimet përfundimtare (shih Kutinë 3.)

#### Kutia 3. Përbërësit e zinxhirit të rezultateve – Disa përkufizime

Një zinxhir tipik i rezultateve përcakton elementet e mëposhtme:


- inputet janë burimet financiare, njerëzore, materiale, kohore që investohen për kërkesat formale të parapara nga akti juridik;
- aktivitetet janë ndërhyrjet e prekshme që rezultojnë nga përdorimi i inputeve. Kryerja e aktiviteteve siguron që kërkesat formale ligjore janë zbatuar dhe janë të zbatueshme;
- produktet përfshijnë efektet e menjëhershme që rezultojnë nga zbatimi ose miratimi i kërkesave formale të parapara nga akti juridik;
- rezultatet përfaqësojnë ndryshime në sjellje dhe në performancë në institucione ose në mesin e individëve ose grupeve, të cilat rezultojnë nga pajtueshmëria me (dhe zbatimi i) kërkesave ligjore; dhe
- ndikimet janë rezultatet përfundimtare të arritura, të cilat zakonisht synojnë të jenë pozitive, që rrjedhin nga ndryshimet e shkaktuara nga realizimi i të gjitha rezultateve.

Zinxhiri i rezultateve ndërtohet duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve: (shih Figurën 3.)

- Çfarë lloj ndërhyrjesh ose masash/veprimesh është dashur të ndërmerren si rezultat i aktit juridik?
- Si pritet të reagojnë aktorë të ndryshëm për këto masa/veprime të cilat rrjedhin nga akti juridik?
- Çfarë lloj rezultatesh mund të nxiten për të arritur ndryshimin ose qëllimin e synuar?

Zinxhiri është një mjet pune për të ndërtuar vlerësimin *Ex-Post*. Një zinxhir rezultatesh përcakton logjikën shkakore nga zbatimi i veprimeve nga akti juridik, duke filluar me burimet në dispozicion, deri në rezultat/qëllimin përfundimtar, duke shikuar në synimet afatgjata. I njëjti përshkruan zinxhirin logjik se pse dhe si një veprim/masa e veçantë i aktit juridik do të arrijë rezultat/qëllimin e dëshiruar (p.sh. ruajtje të ambientit, zvogëlimi i lëndimeve në punë) duke përshkruar një sekuencë të inputeve, aktiviteteve, produkteve dhe rezultateve. Zinxhiri përcakton një skicë logjike dhe të besueshme se si një sekuencë inputesh, ndërhyrjesh dhe produkteve, të cilat bien nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të zbatuesve të aktit juridik ndërvepron me ndryshimet e sjelljes dhe performancës së subjekteve dhe përfituesve për të vendosur shtigje përmes të cilave arrihen rezultatet përfundimtare ose ndikimi.

Figura 3. Ndërtimi i zinxhirit të Rezultateve





**Shënim:** Nëse ekziston koncepti dokumenti, dhe i njëjti ka të zhvilluar edhe zinxhirin e rezultateve të pritura, atëherë këto rezultate mund të shfrytëzohen për vlerësimin Ex-Post. Në këtë aspekt, detyra e grupit punues mbetet t'a përcaktojë nëse zinxhiri i rezultateve që është përshkruar në Koncept Dokument është i përshtatshëm për shfrytëzimin gjatë vlerësimit Ex-Post.


**Shënim:** Kur hartohet zinxhiri i rezultateve, grupi punues duhet t'i identifikojë saktë të gjitha palët e interesuara përkatëse që preken nga akti juridik dhe/ose që duhet të Apërfshihen në vlerësimin Ex-Post. Lista e palëve të interesuara duhet të gjithëpërfshirëse.

Referojuni **Shtojcës A.3.** për informacion të hollësishëm se si t'i identifikoni palët e interesuara përkatëse për vlerësimin Ex-Post.

### 3.2. HAPI 2: Zgjedhja e llojit të vlerësimit

Përpunimi i zinxhirit të rezultateve ndihmon në formësimin e të gjithë procesit të vlerësimit, duke filluar nga përcaktimi i llojit të vlerësimit që duhet ose mund të kryhet dhe pyetje kryesore të lidhura me vlerësimin përkatës. Në këtë drejtim, Figura 4 pasqyron segmentet e zinxhirit të rezultateve që zakonisht mbulon çdo lloj vlerësimi. Secili lloj nga ana tjetër mund të shoqërohet me kritere dhe pyetje të ndryshme, siç përshkruhet në hapat 3 dhe 4.

**Figura 4.** Modeli i zinxhirit të rezultateve dhe hartimi/dizajni i vlerësimit: Vështrim i përgjithshëm



Siç u theksua në pjesën 1.2. më lartë, grupi punues mund t'a shqyrtojë realizimin e tri llojeve të vlerësimit. Të gjitha vlerësimet duhet të përfshijnë një "Vlerësim të Zbatimit dhe Pajtuëshmërisë", por jo të gjitha mund të përfshijnë një "Vlerësim të Performancës" ose një "Vlerësim të Ndikimit".

Kutia 4 i rradhit faktorët që grupi punues duhet t'i ketë parasysh kur vendosë në përzgjedhjen e vlerësimit.

#### Kutia 4. Përzgjedhja e llojit të duhur të vlerësimit Ex-Post

Konsideratat në vijim i ndihmojnë grupit punues t'a përzgjedhë llojin më të përshtatshëm të vlerësimit Ex-Post:

- **objektivat e përgjithshme të vlerësimit:** kjo lidhet me kërkesën nga politikëbërësit dhe qëllimin e vlerësimit. Për shembull, nëse qëllimi i vlerësimit është të përcaktojë se përse palët e interesuara nuk kanë zbatuar aktin juridik (d.m.th. shkalla e pajtuëshmërisë është e ulët), atëherë duhet të zgjedhet Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtuëshmërisë (mundësisht me marrjen në konsideratë dhe matjen e barrës administrative aty ku është e aplikueshme). Kurse, nëse qëllimi i vlerësimit është të përcaktojë nëse ndikimet përfundimtare janë arritur, atëherë duhet të zgjedhet Vlerësimi i Performancës ose Vlerësimi i Ndikimit;
- **kompleksiteti i "zinxhirit të rezultateve":** aty ku zinxhiri është kompleks dhe ndikon në shumë rezultate të ndryshme, atëherë duhet të zgjedhet Vlerësimi i Performancës, për të siguruar prova të mjaftueshme për nivelin e realizimit të rezultateve të krijuara nga zbatimi i aktit juridik;
- **burimet ekzistuese të të dhënave dhe matshmëria e rezultateve:** nëse ekziston tashmë një gamë e gjerë burimesh të të dhënave me cilësi të mirë, që i mbulojnë ndërhyrjet nga akti juridik si dhe rezultatet e krijuara për grupet e trajtimit edhe për grupet e kontrollit (analizat krahasimore), atëherë rekomandohet të kryhet një Vlerësim i Ndikimit. Përndryshe, nëse kjo situatë nuk është e krijuar, rekomandohet të kryhet Vlerësimi i Performancës
- **koha dhe disponueshmëria e burimeve:** në shumicën e rasteve, vlerësimet e ndikimit do të kërkojnë kryerjen e një ankete reprezentative dhe organizimin e një ekipi të dedikuar kërkimor, shpesh të kontraktuar nga jashtë grupit punues dhe institucionit. Kjo mund të nënkuptojë një angazhim të konsiderueshëm kohe dhe burimesh. Nga ana tjetër, Vlerësimi i Performancës mund të menaxhohet me më pak burime dhe mund të kryhet më shpejt në krahasim me Vlerësimin e Ndikimit – ndërsa vlerësimet e zbatimit dhe të pajtuëshmërisë mund të kërkojnë qasje vetëm në të dhënat e brendshme administrative;
- **koha e vlerësimit:** Vlerësimi i ndikimit përfundimtar është më i realizueshëm dhe gjetjet më të besueshme, sa më gjatë të kalojë koha që nga fillimi i zbatimit të aktit juridik. Nëse vlerësimi bëhet relativisht shpejt pas hyrjes në fuqi të aktit juridik, mund të bëhet vetëm Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtuëshmërisë ose një Vlerësim i pjesshëm i Performancës.

Logjika e ndërhyrjes i ndihmon grupit punues t'a zgjedhë llojin e duhur të vlerësimit (shih Figurën 3 më lartë). Më konkretisht:

- **Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtuëshmërisë:** Ky lloj vlerësimi lidhet me pjesën e poshtme të zinxhirit të rezultateve, me fjalë të tjera, përqëndrohet në inputet, aktivitetet dhe produktet e zinxhirit të rezultateve. Ky lloj vlerësimi mund të realizohet relativisht shpejt pas hyrjes në fuqi të aktit juridik por jo para një viti të hyrjes në fuqi të aktit juridik.
- **Vlerësimi i Performancës:** Nëse ka kaluar kohë e mjaftueshme nga hyrja në fuqi e aktit juridik dhe nëse aktivitetet janë zbatuar plotësisht (diçka që duhet të përcaktohet përmes Vlerësimit të Zbatimit dhe Pajtuëshmërisë), vlerësimi Ex-Post mund të merret ose të kalon në hallkën tjetër në zinxhirin e rezultateve – d.m.th., deri në çfarë mase janë materializuar

produktet e intervenimit, nëse këto e kanë shkaktuar ndryshimin e pritur në sjelljen e grupeve të synuara (rezultatet fillestare), dhe nëse akti juridik ka kontribuar në arritjen e objektivave përfundimtare (rezultatet e ndërmjetme dhe ndikimet përfundimtare).

- **Vlerësimi i Ndikimit:** Vlerësimi i Ndikimit mund të nisë vetëm nëse disponohen të dhëna të mjaftueshme për t'a përcaktuar se "si do të kishin ndodhur gjërat nëse akti juridik nuk do të ishte zbatuar". Kjo varet nga aftësia për të përcaktuar se çfarë do të kishte ndodhur me "grupin(et) e kontrollit" në mungesë të aktit juridik, pastaj të bëhen krahasime me "grupin e trajtimit" që i është nënshtruar dispozitave të aktit juridik. Kjo shpesh kërkon që të kalojnë disa vite që nga zbatimi i aktit juridik. Vlerësimi i Ndikimit është një vlerësim më kompleks, pasi sa më shumë të lëvizim sipas zingjirit të rezultateve, aq më shumë ka mundësi që konteksti i përgjithshëm të ketë ndryshuar dhe faktorët e jashtëm të kenë bashkë-ndikuar në arritjen e qëllimeve të ndjekura dhe llojin e rezultateve që duhet të vlerësohen. Prandaj, atribrimi i lidhjes shkakore të drejtpërdrejtë ndërmjet hapave të ndryshëm të zinxhirit të rezultateve siç shkaktohet nga akti juridik bëhet gjithnjë e më pak i sigurt (shih Figurën 3 më lart). Për këto arsye, për t'a kryer një Vlerësim të Ndikimit, grupi punues duhet që jo vetëm së pari t'a kryejë Vlerësimin e Zbatimit dhe Pajtueshmërisë, por gjithashtu të siguroheni se ka kohë dhe burime të mjaftueshme për kryerjen e këtij vlerësimi.

Shih Shtojcën A.4. për një shtjellim të hollësishëm të llojeve të vlerësimit.

Ndonjëherë, është e mundur të përcaktohet lloji përfundimtar i vlerësimit vetëm pasi të ketë filluar procesi i vlerësimit, sepse jo i gjithë informacioni është në dispozicion që në fillim dhe të dhënat krijohen ose kontekstualizohen ndërkohë gjatë kryerjes së vlerësimit. Për këtë arsye, është e rëndësishme që vlerësimi të bazohet në një qasje të strukturuar, e cila është e kornizuar nga të ashtuquajturat "pyetjet e vlerësimit". Formulimi i pyetjeve të duhura është hapi tjetër në kryerjen e vlerësimit Ex-Post.

### 3.3. HAPI 3: Përcaktimi i kriterëve dhe pyetjeve të vlerësimit

Në çdo rast grupi punues duhet t'i marrë parasysh kriteret kryesore të vlerësimit të përcaktuara nga OECD (shihni Kutinë 5).

#### Kutia 5. Kriteret kryesore të vlerësimit

- **Rëndësia:** A është akti juridik i përshtatshëm për adresimin e nevojave të caktuara? - Ky kriter mat se deri në çfarë mase objektivat e aktit juridik u përgjigjen nevojave, politikave dhe prioriteteve të përfituesve, vendit dhe institucionit, dhe vazhdojnë t'u përgjigjen nëse rrethanat ndryshojnë.
- **Harmonizimi:** A është akti juridik në harmoni me kornizën ligjore? - Ky kriter merr parasysh pajtueshmërinë e aktit juridik me aktet tjera juridike që janë në fuqi në Kosovë (harmonizimi i brendshëm) si dhe konsistencën e aktit juridik me traktatet, marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse, normat apo standardet tjera të nënshkruara nga Kosova (harmonizimi i jashtëm).
- **Efektiviteti:** A i arrin akti juridik objektivat e tij? - Ky kriter trajton se deri në çfarë mase akti juridik ka arritur ose pritet t'i arrijë objektivat dhe rezultatet e tij, duke përfshirë edhe rezultatet e ndryshme midis grupeve.
- **Efikasiteti:** A janë përdorur burimet në mënyrë efikase? - Ky kriter trajton se deri në çfarë mase akti juridik jep, ose ka të ngjarë të japë rezultate në mënyrë ekonomike dhe në kohë. "Efikasiteti" është shndërrimi i inputeve (fondet, ekspertiza, burimet natyrore, koha, etj.) në produkte, rezultate dhe ndikime, me koston më efektive të mundshme, krahasuar me mundësitë alternative e realizueshme në kontekstin aktual. Arritja e rezultateve në kohë, nënkupton realizimin e rezultateve brenda kornizës kohore të synuar, ose një afati kohor të përshtatur në mënyrë të arsyeshme.
- **Ndikimi:** Çfarë ndikimi ka sjellë akti juridik? - Ky kriter shqyrton deri në çfarë mase akti juridik ka krijuar ose pritet të krijojë efekte të përgjithshme pozitive ose negative, të synuara ose të paqëllimta, të nivelit më të lartë (duke pasqyruar objektivat origjinale të deklaruara të aktit juridik).
- **Qëndrueshmëria:** A do të zgjasin përfitimet ose efektet? - Ky kriter merr në konsideratë deri në çfarë mase përfitimet<sup>4</sup> të aktit juridik vazhdojnë ose ka të ngjarë të vazhdojnë.

Burimi: Përshtatur nga OECD, *Kriteret e Vlerësimit, në dispozicion në:*

<https://www.oecd.org/dac/evaluation/dacriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.htm>.

Një ose disa kriterë vlerësimi mund të lidhen me secilin lloj vlerësimi, varësisht nga lloji i informacionit që ka për detyrë t'u japë vendimmarrësve. Tabela 1 rendit kriteret kryesore të vlerësimit si dhe shembuj të pyetjeve tipike të vlerësimit. Në tabelë gjithashtu lidhen kriteret me llojet e vlerësimit.

4 Si dhe përfitimet neto (pra, dallimi mes përfitimeve/efekteve të realizuara pa aktin juridik, dhe atyre të realizuara si rrjedhojë e aktit juridik) kur realizohet vlerësimi i ndikimit.

**Shënim:** Kur merret parasysh kriteri i “efikasitetit”, grupi punues duhet të masë **barrën administrative** të krijuar nga akti juridik, në përputhje me **Modelin përkatës të Kostimit Standard**. Nëse nuk bëhet kjo matje, grupi punues duhet t’i arsyetojë shkaqet në mënyrë të qartë në raportin e vlerësimit.

**Shënim:** Grupi punues duhet ta arsyetojë çdo kufizim të qëllimshëm të zbatimit të kritereve të vlerësimit të OECD-së. Kriteri i “qëndrueshmërisë” zakonisht nuk mbulohet nga vlerësimi Ex-Post i akteve juridike për shkak se nënkupetohet se akti juridik duhet të zbatohet (dhe në këtë mënyrë krijon përfitime) për sa kohë që ai mbetet në fuqi. Grupi punues duhet gjithashtu të konsiderojë të marrin parasysh çështjet ndërsektoriale (p.sh. gjinia).

**Tabela 1.** Kriteret dhe pyetjet kryesore të vlerësimit, dhe llojet e vlerësimit përkatës

Kriteret	Pyetje vlerësimi (shembull)	Lloji i vlerësimit
Ligjshmëria	<p><b>Ligjshmëria e aktit juridik</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A është nxjerrë akti juridik në përputhje me kornizën ligjore?</li> <li>A është akti juridik në fuqi?</li> </ul>	Të tri llojet
Zbatueshmëria	<p><b>Deri në çfarë mase janë përmbushur detyrimet ligjore të parapara nga akti juridik?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Cilat janë detyrimet që dalin nga akti juridik, a janë zbatuar apo a janë duke u zbatuar, kur dhe nga kush?</li> <li>Cilat janë inputet e vëna në dispozicion për zbatimin? A janë përdorur ato?</li> <li>Sa ka përparuar zbatimi?</li> <li>Çfarë vështirësish ka pasur në procesin e zbatimit?</li> <li>Kush (dhe kush jo) ka vepruar në përputhje me detyrimet ligjore të parapara me aktin juridik?</li> <li>A ka hapësirë për ta përmirësuar zbatimin dhe pajtueshmërinë?</li> </ul>	Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë
Efektiviteti	<p><b>Deri në çfarë mase janë arritur ose pritet të arrihen efektet e aktit juridik të definuara në zinxhirin e rezultateve?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A janë arritur produktet, rezultatet dhe ndikimet e pritura?</li> <li>Deri në çfarë mase janë arritur grupet e synuara?</li> <li>A e kanë rregikuar arritjen e objektivave pasojat eventuale të padëshiruara?</li> </ul>	Vlerësimi i Performancës. Vlerësimi i ndikimit

Efikasiteti	<p><b>A janë shndërruar ekonomikisht burimet/inputet (të tilla si fondet, ekspertiza, koha, etj.) në rezultate?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A është e përshtatshme dhe e justifikueshme marrëdhënia ndërmjet inputeve/burimeve dhe rezultateve të arritura? Cili është raporti kosto-përfitim?</li> <li>A ka ndonjë mundësi për të arritur të njëjtat rezultate me më pak inpute? A do të kishim rezultate më të mira me rialokimin e burimeve?</li> <li>A krijon barrë administrative akti juridik? Nëse po, sa? A mund të reduktohet barra nëpërmjet masave të thjeshtimit?</li> </ul>	Të tri llojet
Ndikimi	<p><b>Ndikimi i krijuar nga akti juridik mund të jetë pozitiv dhe negativ, i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, parësor dhe dytësor, afatshkurtër dhe afatgjatë, i dëshiruar dhe i padëshiruar.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A janë arritur objektivat e synuara dhe deri në çfarë niveli janë arritur ato?</li> <li>Deri në çfarë mase mund t’i atribuohen aktit juridik këto objektiva të arritura?</li> <li>A ka ndonjë pasojë të padëshiruar? A janë shkaktuar ato drejtpërdrejt nga akti juridik?</li> <li>Sa e fuqishëm është lidhja shkak-pasojë midis zbatimit të aktit juridik dhe këtyre efekteve?</li> </ul>	Vlerësimi i ndikimit
Qëndrueshmëria	<p><b>Sa është probabiliteti që përfitimet nga zbatimi i aktit juridik të jenë të vazhdueshme dhe afatgjata?</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Deri në çfarë mase do të pritet të vazhdojnë aktivitetet, rezultatet dhe ndikimet e përgjithshme?</li> <li>Sa janë gjasat që përfitimet nga akti juridik të vazhdohet për një periudhë të arsyeshme kohore?</li> <li>Deri në çfarë mase ka arritur akti juridik në ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale dhe krijimin e partneriteteve me palët përkatëse të interesit për të siguruar qëndrueshmëri të përfitimeve?</li> </ul>	Vlerësimi i Performancës. Vlerësimi i Ndikimit

**Harmonizimi dhe përfrimi i aktit juridik me objektivat strategjike dhe politikat e tjera të Qeverisë, si dhe me kornizën ligjore ekzistuese.**

Harmonizimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sa është në pajtueshmëri akti juridik me aktet e tjera juridike në fuqi në Kosovë?</li> <li>Sa është në përputhje akti juridik me marrëveshjet ndërkombëtare dhe normat apo standardet e tjera ndërkombëtare?</li> <li>Sa është në pajtueshmëri akti juridik me objektivat strategjike dhe politikat e tjera të Qeverisë?</li> </ul>	Të tri llojet
-------------	---	---------------

**Deri në çfarë mase objektivat e aktit juridik janë ende në përputhje me kontekstin aktual, nevojat e përfituesve dhe/ose prioritetet dhe politikat e Qeverisë.**

Rëndësia	<ul style="list-style-type: none"> <li>A ka qenë relevante nxjerrja e aktit juridik për t'a trajtuar problemin fillestar? A është ende relevant dhe a duhet ndryshuar/shfuqizuar i njëjti?</li> <li>Sa relevant është akti juridik për grupin e synuar dhe në çfarë mase i trajton nevojat dhe interesat e tyre?</li> <li>Deri në çfarë mase i pasqyron akti prioritetet kryesore aktuale të Qeverisë?</li> </ul>	Të tri llojet
----------	---	---------------

### 3.4. HAPI 4. Përcaktimi i treguesve të performancës

Pasi të hartohet modeli i zingjirit të rezultateve dhe të vendoset lloji i vlerësimit, grupi punues duhet të përcaktojë treguesit e performancës për zinxhirin e rezultateve. Një zinxhir i rezultateve i formuluar qartë ofron një hartë të dobishme për përzgjedhjen e treguesve. Pra, grupi punues duhet t'i identifikojë të paktën katër nivele treguesish:

1. Treguesi për zbatimin;
2. Treguesi për ndryshimet në sjellje;
3. Treguesi për ndryshimet në performancë (kur është e aplikueshme), dhe
4. Treguesi për rezultatin përfundimtar (treguesi i ndikimit).<sup>5</sup>

Treguesit janë ato matje sasiore ose cilësore që specifikojnë se çfarë duhet të matet, në mënyrë që të konstatohet nëse është duke u arritur progres përgjatë zinxhirit të rezultateve - nga zbatimi deri në arritjen e ndikimeve.

Treguesit mund të jenë cilësorë ose sasiorë. Numri i treguesve që lidhen me secilin segment të zinxhirit varet nga sa tregues janë të nevojshëm për t'iu përgjigjur pyetjes “A është mbulluar në mënyrë adekuate

<sup>5</sup> Nga ana tjetër, “treguesit e tërthortë” përdoren kur rezultatet nuk mund të maten drejtpërdrejtë. Një shembull është të matet nëse cilësia e vendimeve gjyqësore është përmirësuar: Kjo mund të matet me tregues tërthortë si përqindja e rasteve gjyqësore të kundërshtuara në gjykatat e nivelit më të lartë.

niveli i “ndryshimit” me këta tregues?” Vlerësuesi duhet t'a shmangë vendosjen e treguesve shumë kompleksë dhe të tepërt. Nganjëherë, më pak është më mirë!

Tabela 2. Treguesit sasiorë dhe cilësorë

Treguesit sasiorë	Treguesit cilësorë
<p>Matja e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sasisë;</li> <li>Numrit;</li> <li>Përqindjes;</li> <li>Raportit.</li> </ul>	<p>Matja e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Perceptimit;</li> <li>Mendimit;</li> <li>Gjykimit;</li> <li>Treguesit faktik/kategorik (Po/Jo).</li> </ul>
<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>numri i grave në pozita vendimmarrëse;</li> <li>nivelet e punësimit;</li> <li>normat e pagave;</li> <li>nivelet e arsimit;</li> <li>normat e shkrim-leximit.</li> </ul>	<p>Shembuj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>perceptimi i grave për fuqizimin e tyre;</li> <li>nivelet e kënaqshmërisë në shërbimet e punësimit;</li> <li>cilësia e jetës;</li> <li>a janë miratuar aktet nënligjore të ligjit për .... (Po/Jo).</li> </ul>
Metoda e mbledhjes së të dhënave	Metoda e mbledhjes së të dhënave
<p>Zakonisht (por jo gjithmonë) anketa ose pyetësorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Më e përshtatshme për sektorët që ofrojnë shërbime.</li> </ul>	<p>Zakonisht intervistat gjysmë të strukturuar dhe tryeza të rrum-bullakëta, fokus grupet, anketat e qëndrimeve, vëzhgimi/vizitat e pjesëmarrësve në terren, dëshmitë, kartat e rezultateve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Më e përshtatshme për fusha të tilla si qeverisja e mirë, reforma e politikave ose ndërtimi i kapaciteteve institucionale.</li> </ul>

**Shënim:** Kur përcaktohen treguesit grupi punues duhet ta ketë parasysh rregullin “K.R.E.A.M.”: Treguesit duhet të jenë:

- **i kuptueshëm** (i saktë dhe jo i paqartë);
- **relevant** (i përshtatshëm për ndryshimin në fjalë);
- **ekonomik** (i disponueshëm me kosto të arsyeshme);
- **adekuat** (në gjendje të ofrojë bagë të mjaftueshme për ta vlerësuar performancën ose ndryshimin);
- **i monitorueshëm** (të përshtatshme për të vërtetuar ndryshimin).

Burimi: Grupi i Bankës Botërore (2009): *Rruga drejt rezultateve: Projektimi dhe Kryerja e Vlerësimit të Zhvillimit Efektiv nga Linda G. Morra Imas, Ray C. Rist.*



### 3.5. HAPI 5: Identifikimi i kërkesave të të dhënave / mbledhjes së të dhënave

**Treguesit e performancës e përcaktojnë se cilat të dhëna nevojiten.** Të dhënat specifike të kërkuara për një vlerësim do të lidhen me inputet, produktet, rezultatet dhe ndikimet e aktit juridik.

Ndonjëherë të dhënat e vlerësimit janë mjaft të drejtpërdrejta dhe lehtësisht të qasshme, sepse tashmë ekzistojnë sisteme për mbledhjen e atyre të dhënave dhe mbajtjen e shënimeve. Ky është, për shembull, rasti kur janë krijuar baza të të dhënave (statistikore). Por, në raste të tjera, gjetja e të dhënave përkatëse është më e vështirë.

Faza e parë në aktivitetin e mbledhjes së të dhënave është rishikimi i asaj që është tashmë e disponueshme. Të dhënat mund të ndahen në:

- të dhënat që tashmë janë duke u mbledhur nga institucioni përkatës ose organizatat tjera që kanë të bëjnë me aktin juridik;
- të dhënat ekzistuese që janë mbledhur nga institucionet tjera por që nuk kanë të bëjnë me aktin juridik;
- të dhëna të bazuara në anketa strukturore të menaxhuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ose nga organizatat tjera (vendore dhe ndërkombëtare).

Nëse asnjë prej këtyre llojeve të të dhënave nuk është i disponueshëm ose është i disponueshëm vetëm pjesërisht, atëherë grupi punues duhet t'a organizojë mbledhjen e të dhënave të reja për nevojat e vlerësimit. Kutia 6 udhëzon se si duhet kryer ky proces. Tutje, Shtojca A.5. ofron detaje mbi metodat e mbledhjes së të dhënave dhe sugjeron përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të secilës prej tyre.

#### Kutia 6. Shqyrtimet kryesore kur planifikoni mbledhjen e të dhënave

- Çfarë të dhënash duhen mbledhur për matje të besueshme dhe të qëndrueshme ndaj objektivit të vendosur me aktin juridik?
- Çfarë të dhënash shtesë duhet të mbledhen për t'i përmbushur kërkesat e vlerësimit?
- Kush do t'a ketë përgjegjësinë për mbledhjen e të dhënave?
- Kur do të mblidhen të dhënat? Cilat janë afatet kryesore për mbledhjen e tyre?
- Si do të mblidhen, transferohen dhe ruhen të dhënat?
- Në çfarë formati kërkohen të dhënat?
- Si do të verifikohen të dhënat për t'u siguruar që janë të sakta dhe në përputhje me kërkesat përkatëse?

Burimi: HM Thesari (2011): Libri Magenta, Udhëzues për Vlerësim

**Shënim:** Mbledhja e të dhënave bëhet me qëllim që vlerësimi të jetë i bazuar në prova. Ndarja e të dhënave në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë fetare, etnike, racore, ose personat me aftësi të kufizuara etj., është e rëndësishme nëse vlerësimi Ex-Post i aktit juridik bëhet me qëllim të vlerësimit të efekteve të aktit juridik lidhur me këto grupe. Analiza e zbërthyer mund të ndihmojë në identifikimin e perspektivës alternative për problemin e caktuar dhe të merren parasysh masat adekuate / plotësuese për t'i minimizuar ndikimet e mundshme negative ose për t'i maksimizuar ndikimet e mundshme pozitive në grupe të caktuara nga akti juridik.

### 3.6. HAPI 6: Përpunimi i “Matricës së Vlerësimit”

Pasi të përfundohen të gjithë hapat, grupi punues mund t'a plotësojë të ashtuquajturën “Matrica e Vlerësimit”. Kjo është një tabelë që e përmbledh të gjithë informacionin përkatës në lidhje me vlerësimin Ex-Post. Matrica e Vlerësimit përfshin përshkrimet e rezultateve si dhe produkteve dhe burimeve që dalin nga zinxhiri i rezultateve, treguesit e tyre të performancës, informacionin bazë dhe caqet e treguesve (nëse ka), metodat dhe burimet e mbledhjes së të dhënave, afatin kohor kur do të mblidhen të dhënat dhe kush është përgjegjës për prodhimin, mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave.

Shtojca A.6. ofron një matricë tipike të Vlerësimit.

# Pjesa 4: Konsideratat organizative



Në parim, burimet (njerëzore dhe financiare) e dedikuara për një vlerësim *Ex-Post* duhet të jenë proporcionale me nivelin dhe llojin e aktit juridik dhe efektet e synuara të tij. Grupi punues duhet t'a marrë parasysh nivelin dhe llojin e vlerësimit që kërkohet për një akt juridik të caktuar dhe çfarë do të ofrojë çdo lloj dhe nivel të vlerësimit dhe çfarë nuk do të ofrojë. Për shembull, nëse pjesë të vlerësimit *Ex-Post* duhet të realizohen nga palë të jashtme apo të kryhen tërësisht brenda institucionit.

#### 4.1. Llojet e burimeve të kërkuara në vlerësim

Kur bëhet një vlerësim, grupi punues duhet t'a ketë parasysh se çfarë burimesh financiare dhe njerëzore i nevojiten.

##### *Burimet financiare*

Një kosto e madhe dhe e ndryshueshme në vlerësimin *Ex-Post* është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave. Natyrisht, kostoja do të jetë dukshëm më e ulët nëse grupi punues mund të mbështetet në të dhënat ekzistuese të besueshme. Kërkohen më shumë burime financiare për Vlerësimin e Ndikimit në krahasim me Vlerësimin e Performancës. Burime shtesë financimi nevojiten nëse vendoset që vlerësimi të kryhet nga palë e jashtme (shih më poshtë).

##### *Burimet njerëzore*

Pavarësisht nëse vlerësimi realizohet nga burimet e jashtme apo nga burimet e brendshme njerëzore, një vlerësim *Ex-Post* kërkon të paktën një person të përkushtuar me ekspertizë të fortë analitike dhe teknike.

- Në rast të vlerësimit të brendshëm, zyrtarët e qeverisë përgjegjës për vlerësimin duhet t'a hartojnë zinxhirin e rezultateve, t'i identifikojnë treguesit e performancës, të mbledhin dhe grumbullojnë informacion mbi treguesit e performancës, nëse është e nevojshme të kryejnë mbledhjen e re të të dhënave për të mbushur boshllëqet e të dhënave, t'a analizojnë informacionin e mbledhur dhe të krijojnë një raport vlerësimi. Varësisht nga natyra e vlerësimit në fjalë, mund të jetë nevojitet përfshirja e një ekipi multi-disiplinor ekspertësh (të brendshëm dhe/ose të jashtëm). Në fazën e hartimit, për shembull, stafi me përvojë nga ministritë e tjera ose specialistë të vlerësimit të jashtëm mund të këshillojnë mbi fizibilitetin e realizimit së llojeve të ndryshme të vlerësimit.
- Gjithashtu, në rast të një vlerësimi nga burimet e jashtme, institucioni propozues mbetet përgjegjës për realizimin e vlerësimit *Ex-Post* (shih Pjesën 4.2 më poshtë). Përgjegjësia e institucionit propozues mbulon së paku (i) përcaktimin e fushëveprimit të vlerësimit; (ii) përzgjedhjen e llojeve të vlerësimit; (iii) vendosjen e kriterëve të vlerësimit; (iv) zhvillimin e Termave të Referencës; dhe (v) përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe përzgjedhjen e kontraktuesit. Institucioni propozues është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e përditshëm, duke përfshirë këshillimin dhe sigurimin e cilësisë gjatë realizimit të vlerësimit nga burimet e jashtëm. Niveli i inputeve të kërkuara do të jetë më i madh në momentet kyçe (në veçanti, faza e hartimit dhe kontraktimit), por do të ketë kërkesë të vazhdueshme për punë edhe gjatë realizimit. Në vlerësimet e jashtme, institucionet propozuese mund të vendosin që t'a kontraktojnë edhe hartimin e vlerësimit (hapat e përshkruar në seksionin 2 të Manualit), dhe jo vetëm realizimin e vlerësimit.

##### *Palët më të gjera të interesit*

Vlerësimi mund të përfshijë edhe palë të tjera të interesit – për shembull, qytetarë të zakonshëm ose organizata të palëve të prekura drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga akti juridik. Niveli i përfshirjes dhe metoda e angazhimit do të jenë specifike për çdo vlerësim *Ex-Post*. Grupi punues mund t'i ftojë ata në takimet e grupit punues, t'i informojë rreth vlerësimit ose t'i angazhojë në metodat e mbledhjes së të dhënave.

#### 4.2. Hartimi/Dizajni dhe relazimin e vlerësimit *Ex-Post* nga institucioni propozues ose me angazhim të jashtëm

Ndonëse institucioni propozues është bartës i procesit të vlerësimit *Ex-Post*, ai mund të angazhojë ose kontraktojë ekspertizë jashtë institucioneve për kryerjen e plotë të vlerësimit ose vetëm disa pjesëve të tij.

Pavarësisht nëse përdoret apo jo ekspertiza e jashtme, vlerësimet kërkojnë kontribut të konsiderueshëm nga institucioni propozues, ashtu edhe nga anëtarët e grupit punues dhe nga ZKM. Në çdo rast, grupi punues për kryerjen e vlerësimit *Ex-Post* brenda institucionit propozues mbetet kryesisht përgjegjës për dy detyra kryesore:

- përcaktimi i hartimit/dizajnit të vlerësimit *Ex-Post* (duke ndjekur hapat 1-6 të elaboruar më sipër), i cili ka si rezultat matricën e Vlerësimit, dhe
- sigurimi i kontrollit të cilësisë gjatë procesit të realizimit dhe gjetjet e vlerësimit *Ex-Post*.

Aktivitetet tipike për të cilat mund të angazhohet apo kontraktohet ekspertizë e jashtme përfshijnë kryerjen e anketave dhe metodave të tjera për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre, si dhe për analizën e të dhënave. Në rastin e Vlerësimeve të Ndikimit kërkesa për ekspertizë të jashtme për hartimin, realizimin e vlerësimit si dhe për mbledhjen e të dhënave do të ishte shumë më e madhe.

Institucioni propozues mund të kërkojë mbështetje të jashtme në fazën e hartimit/dizajnit të vlerësimit, ndërkohë që vlerësimi mund të kryhet më pas nga vetë institucioni. Në këtë rast, mbështetja e jashtme ndihmon në përpunimin e Planit të Vlerësimit dhe matricën e vlerësimit, por kompetenca kryesore për realizimin e vlerësimit *Ex-Post* mbetet te institucioni propozues.

Nëse një institucion propozues zgjedh të angazhojë ekspertizë të jashtme si në fazën e hartimit/dizajnit, ashtu edhe në fazën e kryerjes së vlerësimit *Ex-Post*, institucioni propozues mund të vendosë të kontraktojë dy subjekte të ndryshme- njërin për bashkë-hartim të Planit dhe Matricën e Vlerësimit dhe tjetrin për realizimin e vlerësimit *Ex-Post* - për të shmangur ndonjë konflikt interesi.

Por njëkohësisht, institucioni propozues mund të vendosë të procedojë me disa hapa të hartimit/dizajnit të vlerësimit *Ex-Post*, siç janë përzgjedhja e fushës së vlerësimit, lloji i vlerësimit (hapi 2) dhe kriteret e vlerësimit (hapi 3), dhe të angazhojë kontraktuesin për zhvillimin e hapave të tjerë (si hapi 1 dhe hapat 4 - 6).

Institucioni propozues gjithëashtu mund vendos t'a kontraktojë të gjithë vlerësimin (si hartimin/dizajnimin ashtu edhe vlerësimin) nga jashtë. Në varësi të modalitetit për kontraktimin e ekspertizës së jashtme që zgjidhet, grupi punues për vlerësimin *Ex-Post* duhet t'i kryejë të paktën detyrat e mëposhtme:

- Zhvillon dhe finalizon Planin e Vlerësimit si dhe hartimin/dizajnin e vlerësimit (në vijim të hapave 1-6 të shpjeguar më sipër) vetë ose me kontraktorin e jashtëm ose siç u shpjegua pak më lart, institucioni propozues mund të vendosë të përcaktojë disa hapa nga plani i vlerësimit dhe të kërkojnë që hartimi i vlerësimit të zhvillohet dhe të propozohet nga kontraktorët.
- Finalizon Termat e Referencës së bashku me dokumentet e tenderimit dhe procedurat e prokurimit që realizohen sipas procedurave përkatëse të prokurimit publik.
- Pas nënshkrimit të kontratës me kontraktorin, grupi punues rekomandohet të organizojë një takim prezantues në të cilin diskutohen në detaje çështjet specifike të temës, si dhe zbatimin e termave të referencës.
- Ofron mbështetje të nevojshme për realizimin e vlerësimit nga kontraktori, duke përfshirë lehtësimin e qasjes në bazat e të dhënave të administratës publike.
- Diskuton rreth planit të punës, duke përfshirë kur duhet të bëhet mbledhja e të dhënave parësore, dytësore, dorëzimi i raporteve fillestare, të ndërmjetme dhe përfundimtare, organizimi i punëtorive përkatëse sipas rastit etj.
- Kryen rolin e kontrollit të cilësisë duke siguruar që vlerësimi realizohet në afatet e parapara dhe duke shqyrtuar dhe ofruar komente thelbësore për draft raportet e vlerësimit *Ex-Post*.

### Kutia 7. Përcaktimi i termave të referencës për kontraktimin e jashtëm

Termet e Referencës (ToR) duhet të mbulojnë fushëveprimin dhe qëllimin e vlerësimit Ex-Post, dhe mënyrën se si do të kryhet dhe zbatohet vlerësimi. Zakonisht, një ToR përfshin:

- informacionin bazë për aktin juridik i cili do të vlerësohet;
- llojin e rezultateve të synuara të aktit juridik që vlerësohet,
- audiencën dhe qëllimin e synuar të vlerësimit;
- informacionin e disponueshëm, për shembull proceset e monitorimit të mbledhjes së të dhënave tashmë të krijuara;
- Kërkesat për mbledhjen e të dhënave të vlerësimit (përndryshe mund të kërkohej nga kontraktori për t'u propozuar dhe zhvilluar më tej);
- llojin ose llojet e parapara të vlerësimit (ose kërkon nga kontraktori t'a zhvillojë atë);
- aftësitë, shkathtësitë dhe përvojën e kërkuar të ekipit të propozuar të vlerësimit;
- produkti final të vlerësimit dhe afatet kryesore që duhen përbushur;
- kërkesat për dorëzimin e raportit dhe të dhënave;
- planin kohor të vlerësimit, dhe
- formatin e raportit dhe prezantimit.

### 4.3. Përgatitja e raportit të vlerësimit Ex-Post

Raporti i vlerësimit *Ex-Post* është produkti kryesor i procesit të vlerësimit, që paraqet vlerësimet e grupit punues për aktin juridik të bazuar në prova. Grupi punues duhet t'i paraqesë ose të sigurojë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet janë paraqitur në mënyrë të dobishme për politikëbërësit dhe që mund të përdoret si bazë për zhvillimin e politikave në të ardhmen.

Përgatitja e raportit të vlerësimit *Ex-Post* sipas standardeve uniforme rrit transparencën dhe qëndrueshmërinë si dhe shanset që gjetjet e vlerësimit të bëhen relevante për të informuar vendimmarrjen.

Pjesa numër 5 e këtij Manuali përshkruan strukturën që duhet të ndiqet për çdo raport të vlerësimit *Ex-Post*, dhe jep udhëzime se çfarë duhet të përfshihet në secilën pjesë të raportit.

### Udhëzime për raportin

- raporti duhet të jetë i qartë, konciz dhe gjithëpërfshirës;
- raporti duhet të përmbajë gjetjet kryesore dhe përfundimet duhet të derivojnë nga këto gjetje;
- në raport duhet të përdoren bullet points (pikat kyçe) për t'i përmbledhur në mënyrë sa më koncize gjetjet brenda raportit;
- raporti duhet të përmbajë justifikime dhe gjetje konkrete, e jo përshkrime të natyrës avokuese;
- raporti nuk duhet t'i neglizhojë pasojat e padëshiruara;
- raporti mund të përmbajë harta, fotografi, grafikone apo tabela, në mënyrë që të transmetojë informacionin sa më qartë edhe vizualisht.

### 4.4. Kontrolli i cilësisë

Cilësia e vlerësimit të kryer është përgjegjësi primare e grupit punues i cili siguron që Raporti i Vlerësimit *Ex-Post* të jetë i plotë dhe i cilësisë së duhur. Institucioni propozues e përcjellë atë për shqyrtim dhe miratim sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Qeverisë për miratimin e këtij Manuali.

Mekanizmat e mëposhtëm ndihmojnë të sigurohet që raporti i përmbush standardet e cilësisë:

- **Shqyrtimi i brendshëm nga institucioni propozues:** Pas përfundimit të raportit nga grupi punues, Raporti i Vlerësimit *Ex-post* rishikohet nga aspekti i kontrollit të cilësisë nga hierarkia e institucioni propozues. Institucioni propozues mund të themelojë edhe panele këshillimore për shqyrtimin e mëtejshëm të draft raportit të vlerësimit *Ex-Post*. Këto panele mund të formohen vetëm për vlerësime më komplekse dhe voluminoze. Ato mund të përfshijnë përfaqësues të autoriteteve të tjera publike dhe/ose të palëve dhe ekspertëve përkatës të jashtëm.
- **Shqyrtimi jashtë institucionit propozues:** kontrolli i cilësisë së raportit të vlerësimit *Ex-Post* bëhet edhe nga Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, nga Këshilli i Drejtorëve të departamenteve ligjore dhe nga Qeveria.

### 4.5. Adresimi i gjeteve të raportit

Raporti i vlerësimit *Ex-Post* duhet të publikohet dhe qëllimi i tij të arrihet përmes adresimit të gjetjeve dhe rekomandimeve që dallin nga raporti.

Pas miratimit të raportit të vlerësimit *Ex-Post*, raporti dërgohet për njoftim tek komisioni përkatës në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mënyrë që të informohet për të gjeturat e vlerësimit.

#### **Publikimi i raportit**

Raporti i vlerësimit *Ex-Post* publikohet në uebfaqen zyrtare të ministrisë (kur është institucion propozues) dhe të Zyrës së Kryeministrit. Megjithatë, institucioni propozues mund të konsiderojë shpërndarjen më aktive të raportit, gjetjeve dhe rekomandimeve të tij tek palët e interesit. Për shkak se raporti i vlerësimit *Ex-Post* është një instrument i vlerësimit të zbatimit të aktit juridik, Qeveria mund t'ia dërgojë Kuvendit raportet e vlerësimit *Ex-Post*-it.



Shpërndarja më e gjerë e rezultateve të vlerësimit rriten më tej nëse institucioni propozues përgatit prezantime në media, ofron intervista, shkruan artikuj dhe organizon evenimente përkatëse si punëtori, tryeza të rrumbullakëta ose me grupe ekspertësh. Ngjarje më të mëdha publike (konferenca) mund të organizohen nëse vlerësohet e nevojshme.

#### Adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të vlerësimit Ex-Post

Raporti i vlerësimit Ex-Post nuk është fundi i procesit të vlerësimit. Pas miratimit të Raportit për vlerësimin Ex-Post të aktit juridik, institucioni propozues duhet të identifikojë veprimet e nevojshme për zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit dhe të njëjtat t'i përfshijë në ciklin e planifikimit dhe vendimmarrjes. Për shembull, nëse një gjetje e Raportit konstaton se nuk janë nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e një ligji, atëherë institucioni propozues e përfshin në planifikim përgatitjen dhe nxjerrjen e këtyre akteve.

#### Pjesa 5: Shablloni i Raportit të Vlerësimit

**Shënim:** Lloji i informacionit dhe i provave që do të përfshihen në raport të vlerësimit Ex-Post ndryshon nga njëri vlerësim në tjetrin, varësisht nga lloji i vlerësimit dhe natyrës së pyetjeve të vlerësimit. Për këtë arsye, plotësimi i shabllonit nuk duhet të jetë prioriteti i parë i grupit punues kur e harton dhe realizon një vlerësim Ex-Post. Pasi të vendoset se cili akt juridik duhet të vlerësohet, pikënisja duhet të jetë përpunimi i “zëngjirit të rezultateve” dhe zbatimi i tij në procesin e vlerësimit, siç përshkruhet në këtë manual.

Institucioni propozues	
Titulli i Raportit të Vlerësimit Ex-Post	
Personi kontaktues	
Grupi punues	
Data	

Ky raport përmbush në mënyrë të kënaqshme standardet e cilësisë së vlerësimit.  
Nënshkrimi

#### PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Një përmbledhje ekzekutive duhet të jepet në fillim të raportit të Vlerësimit Ex-Post, i cili duhet të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të procesit të vlerësimit. Teksti duhet të jetë i qartë dhe konciz (maksimalisht 2-3 faqe), jo-technik, të ofrojë pasqyrën e plotë të vlerësimit, qëllimin e tij, metodologjinë, kufizimet, gjetjet dhe rekomandimet. Çdo terminologji teknike duhet të përshtatet ose të shpjegohet.

## I. HYRJE

### I.1. Konteksti i vlerësimit

*Kjo pjesë e raportit përshkruan arsyet pse akti juridik që vlerësohet është përzgjedhur për vlerësimin Ex-Post.*

### I.2. Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

*Në këtë pjesë përcaktohet qëllimi i vlerësimit dhe si mund të përdoren rezultatet e tij (p.sh. për ta përmbushur një detyrim ligjor, për ta ofruar bazën për një Koncept Dokument të mundshëm në të ardhmen, për ta përmirësuar zbatimin, etj.). Pyetjet që ndihmojnë në strukturimin e kësaj pjese përfshijnë:*

- Cilat janë çështjet kryesore që i trajton vlerësimi?
- Çfarë lloj vlerësimi zbatohet? (Llojet e mundshme mund të jenë «Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë», ose përfshin edhe Vlerësimin e Performancës ose Vlerësimin e Ndikimit).
- Cilat janë kriteret e vlerësimit që do të shqyrtohen?
- Cilën periudhë kohore do të trajton vlerësimi? - që nga fillimi i hyrjes në fuqi të aktit deri më tani, apo periudha të ndryshme kohore (kur trajton një periudhë tjetër kohore shpjegoni pse)?

## II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

### II.1. Përshkrimi i ligjit ose aktit nënligjor që do të vlerësohet

*Përshkruani qëllimin e aktit juridik dhe se si ai ndërlidhet me kornizën më të gjerë të politikave. Nëse ka, Koncept Dokument, i njëjti mund të ofrojë të dhëna të vlefshme.*

- Cilat çështje ka synuar të adresojë akti juridik?
- Cilat pjesë të aktit juridik trajtohen si pjesë e vlerësimit? (Nëse një pjesë nuk është e trajtuar, shpjegoni pse.)
- Cilat palë të interesuara / pjesë të shoqërisë ose ekonomisë ka synuar të ndikonte akti juridik?

### II.2. Zingjiri i rezultateve

*Përshkruani zinxhirin e rezultateve (nga inputet deri te ndikimet) që përbën bazën e punës së vlerësimit, duke treguar logjikën e synuar nga zbatimi i aktit juridik deri te ndryshimet e pritshme dhe rezultatet përfundimtare të synuar. Grupi punuesi mund ta ofrojë edhe një ilustrim vizual të modelit të përdorur.*

- Cilat janë hapat e pritshëm, në zinxhirin e rezultateve, që e strukturojnë ndryshimin logjik në sjellje dhe e zhvendosin ndërhyrjen nga zbatimi deri te produktet, rezultatet dhe ndikimet përfundimtare?
- Cilat janë marrëdhëniet shkakore që e shpjegojnë kalimin nga një hap në tjetrin në zinxhirin e rezultateve?
- Cilët janë treguesit kryesorë të shqyrtuar nga ky vlerësim?
- Cilat supozime e mbështesin modelin?

### II.3. Metodologjia

Në këtë pjesë shpjegohet e gjithë metoda e aplikuar për realizimin e vlerësimit. Raporton për qasjet, detyrat dhe metodat që grupi punues i ka ndjekur gjatë gjithë realizimit për t'i trajtuar të gjitha pyetjet e vlerësimit.

- Cili institucion propozues është përgjegjës për fillimin e vlerësimit? A është angazhuar ekspertizë e jashtme në kryerjen e vlerësimit (ose pjesëve caktuar të tij)? Pse? (të lutem shtoni Termat e Referencës si shtojcë? Si janë monitoruar dhe validuar realizimi i vlerësimit nga jashtë dhe gjetjet e tyre?
- Çfarë hapash proceduralë janë ndjekur nga fillimi deri në përfundim të vlerësimit?
- Cilat palë të interesuara janë konsultuar gjatë vlerësimit? Pse? Përmes cilave kanale?
- Cilat janë burimet e të dhënave të përdorura? Cilat metoda të mbledhjes së të dhënave janë përdorur?
- Cilat kanë qenë kufizimet (nëse ka) që kanë penguar realizimin e vlerësimit?

## III. REZULTATET E VLERËSIMIT

Kjo pjesë i përgjigjet të gjitha pyetjeve të vlerësimit që janë parashtruar për Vlerësimin Ex-Post në mënyrë të qartë dhe koncize, të cilat duhet të jenë të kuptueshme për lexuesin e jashtëm. Kjo pjesë duhet t'i referohet në mënyrë të qartë llojeve dhe kritereve të përdorura në vlerësim (shih Kutinë 1 dhe 5 të Manualit).

Kjo pjesë duhet të jetë analitike dhe e bazuar në dëshmi, duke përdorur sa më shumë tabela/grafikë/fotografi për t'i ilustruar pohimet e bëra. Për t'i prezantuar gjetjet, referojuni hapave të mëposhtëm:

- Shpjegoni organizimet e monitorimit të vendosura për t'a përcjellë zbatimin dhe pajtueshmërinë dhe raportoni për treguesit e ndryshëm të performancës lidhur me zbatimin dhe pajtueshmërinë. Duke vepruar kështu, përshkruani shkallën deri në të cilën masa është zbatuar në momentin e fillimit të vlerësimit. A është identifikuar ndonjë ndryshim i papritur ose i paqëllimshëm i cili ka pasur efekte të përhapura, në fusha të tjera për shkak të nxjerrjes së aktit juridik?
- (Nëse është e mundur dhe relevante) Paraqitni situatën me të cilën krahasohet akti juridik i vlerësuar. Pika të tilla krahasimi mund të jenë për shembull situata para hyrjes në fuqi të aktit juridik, "opsioni i mosveprimit" (skenari bazë) në Koncept Dokument, situata e dëshiruar ose synuar me aktin juridik (skenari për të vepruar) dhe situata e krijuar në momentin e kryerjes së vlerësimit. Kjo duhet t'a lehtësojë krahasimin me situatën aktuale dhe për këtë arsye duhet të mbulojë sa më shumë të jetë e mundur të njëjtat parametra/tregues që përdoren për t'a përshkruar gjendjen e situatës.
- Përdorni informacionin e mbledhur për t'a analizuar se sa përputhen rezultatet e vëzhguara me pritshmëritë e deklaruara kur është miratuar akti juridik, duke iu referuar zinxhirin e rezultateve sipas rastit dhe duke treguar nëse zinxhiri është ndjekur siç pritej apo jo.
- Merrni parasysh ndikimin e vonesave në zbatim;
- Mblidhni burime të ndryshme të dhënash (të referuara qartë në mënyrë që lexuesi të mund të hetojë më tej nëse dëshiron) dhe jepni gjykime të paanshme dhe kritike për atë që është arritur/nuk është arritur; dhe
- Siguroni krahasimin dhe validimin e të dhënave.

Gjetjet duhet të shpjegojnë nëse ka pasur shmangie ose shkëputje nga zinxhiri i rezultateve, dhe nëse po pse. Shfaqja e pasojave të padëshiruara duhet të raportohet dhe analizohet.

### III.1. Pyetje për vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë

Si pjesë e vlerësimit, grupi punues mund t'a konsiderojë shtjellimin e çështjeve të mëposhtme:

- Nëse akti juridik është miratuar në kohë dhe në plotëni. Nëse jo, shpjegoni pse.
- Nëse ka pasur vështirësi në procesin e zbatimit. Në rast se ka pasur, tregoni se cilat ishin ato dhe pse kanë ndodhur.
- Elementet e aktit juridik që janë zbatuar saktë / plotësisht / në kohë (ose jo) dhe shpjegoni pse.
- Nëse akti juridik është zbatuar në mënyrë të duhur.
- Kostoja e zbatimit të aktit juridik. Matni barrën administrative që lidhet me zbatimin dhe përcaktoni nëse kostot dhe barra e tillë mund zvogëlohet.

### III.2. Pyetje për performancën dhe për vlerësimin e ndikimit

Çështjet që grupi punues duhet t'i konsiderojë gjatë përgatitjes së raportit përfshijnë:

- Nëse janë arritur rezultatet e ndërmjetme dhe, efekti përfundimtar (në dy llojet e vlerësimit).
- Nëse janë shfaqur pasojë të padëshiruara (në dy llojet e vlerësimit).
- Si ishte fuqia e marrëdhënies shkak-pasojë ndërmjet zbatimit të ligjit dhe rezultateve (në dy llojet e vlerësimit, por, në rastin e vlerësimit të ndikimit përdoret metodologjia e krahasimit të rezultateve me grupet e kontrollit dhe grupet e tretmanit).
- Kostoja e përgjithshme e arritjes së rezultateve dhe ndikimeve. Vlerësuesi mund t'a përcaktojë nëse kostot e tilla mbahen në minimum ose ka hapësirë për kursim (në dy llojet e vlerësimit).
- Përfitimet që janë krijuar gjatë zbatimit / nga arritja e objektivave (në dy llojet e vlerësimit).
- Si krahasohen gjetjet me situatën e përshkruar në Koncept Dokumentin përkatës (nëse disponohet). (në dy llojet e vlerësimit)
- Palët e interesuara të prekura më së shumti dhe ata që janë ndikuar veçanërisht nga akti juridik. (në të dy llojet e vlerësimit).
- Deri në çfarë masë rezultatet dhe ndikimet pritet të vazhdojnë pas periudhës së vlerësimit (në të dy llojet e vlerësimit)

## IV. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Kjo pjesë e raportit është shumë e rëndësishme sepse lexuesit zakonisht fokusohen në të.

### IV.1. Përfundimet

Përfundimet janë reflektime faktike, objektive dhe neutrale të nxjerra nga gjetjet. Përfundimet duhet të përmbledhin dhe prezantojnë performancën e aktit juridik kundrejt kritereve të përdorura për vlerësim (p.sh. pajtueshmëria, zbatimi, efektiviteti, koherenca, efikasiteti, etj.). Është e rëndësishme të prezantohen se cilat gjetje përputhen me pritshmëritë, cilat gjetje janë shumë preliminare për t'u vëzhguar dhe çfarë nuk ka funksionuar. Meqenëse teksti i përfundimeve shpesh lexohet në mënyrë të pavarur nga teksti i mëparshëm, duhet të ketë një përmbledhje të shkurtër të pjesës I.2. dhe II.3. të shabllonit dhe kufizimeve të vlerësimit. Asnjë detaj apo çështje e re nuk duhet të paraqitet në këtë fazë – të gjitha informacionet përkatëse duhet të paraqiten gjithmonë në seksionin e analizës fillimisht.

Në këtë pjesë të raportit njekohësisht duhet të ofrohet:

- Përmbledhje e gjetjeve kundrejt kritereve të përdorura për vlerësim.
- Mësimet e nxjerra, nëse ka, cilat janë ato?
- Mësimet e nxjerra në lidhje me procesin e vlerësimit, cilat janë ato?



## IV.2. Rekomandimet

Rekomandimet zhvillohen nga përfundimet. Megjithatë, përfundimet nuk duhet të përshkruajnë në mënyrë specifike dhe të detajuar hapat që duhet ndjekur në të ardhmen, përveç nëse vlerësimi identifikon shkaqe të përcaktuara qartë për moszbatim ose hartim të gabuar ligjor. Detyra për të identifikuar opsionet më të përshtatshme për të shtjelluar zbraçëtirat e shfaqura nga Vlersimi Ex-Post është pjesë e kryerjes së vlerësimit të ndikimit ex ante (Koncept Dokumentit).

Seksioni i rekomandimeve përfshin çështjet në vijim:

- Veprimet e rekomanduara për t'a trajtuar secilin përfundim.
- Përcaktohet organi përgjegjës të ngarkuar me zbatimin e rekomandimit, afatet përkatëse dhe rezultatet e pritura.
- Përcaktohen mekanizmat e monitorimit për të siguruar përputhjen me veprimet e rekomanduara.

### SHTOJCAT TEKNIKE

Bashkëngjitni shtojcat teknike përkatëse, sipas rastit. Shtojca të tilla mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- Fjalorin dhe shpjegimin e terminologjisë teknike
- Burimet e të dhënave dhe referencat bibliografike
- Detajet mbi mbledhjen e të dhënave dhe procesin e vlefshmërisë
- Listën e palëve të interesit të konsultuara, një përmbledhje të të dhënave të tyre dhe nëse ato janë mbajtur ose hedhur poshtë në vlerësim (dhe pse)
- Llogaritjet teknike dhe modelet
- Hartat, grafikët, figurat, etj.
- Informacion mbi përfshirjen e ekspertëve/konsulentëve të jashtëm që kanë kryer (pjesë të) vlerësimit.
- Termat e referencës për angazhimin e eksperteve të jashtëm
- Matricën e vlerësimit

# Shtojcat



## Shtojca A.1. Rolet dhe përgjegjësitë për vlerësimin Ex-Post në Kosovë

Vlerësimi Ex-Post është një përpjekje e përbashkët e cila përfshin palët e ndryshme brenda dhe jashtë administratës publike. Secila palë ka role dhe përgjegjësi të caktuara. Kjo shtojcë përshkruan se kush i kryen cilat detyra në përputhje me Vendimin përkatës të Qeverisë për miratimin e Manualit duke shpjeguar dallimin ndërmjet “kryerjes së vlerësimit”, “koordinimit strategjik” dhe “pjesëmarrjes së jashtme”.

### A.1.1. Institucioni propozues: përgjegjës për zhvillimin dhe realizimin e vlerësimit Ex-Post:

Zyra e Kryeministrit apo ministria sponsorizuese e aktit juridik është “bartëse” e procesit të vlerësimit Ex-Post. Ajo e mban përgjegjësinë politike dhe operacionale për vlerësimin *Ex-Post*, pasi është përgjegjëse edhe për formulimin e politikës së përgjithshme dhe për hartimin dhe në zbatimin e aktit juridik. Për këtë arsye, është e rëndësishme që ministrive të linjës t’u ndahen resurset adekuate dhe të zhvillohen kapacitetet në profilet përkatëse për t’u hartuar dhe kryer në mënyrë adekuate vlerësimin Ex-Post.

Ministritë kanë një kufi të caktuar diskrecioni në organizimin e detyrave që lidhen me hartimin, menaxhimin dhe kryerjen e vlerësimeve Ex-Post nga fusha e përgjegjësisë së tyre administrative. Lidhur me këtë, ministritë duhet të marrin në konsideratë rrethanat e mëposhtme:

- **“Departamenti përkatës”:** Departamenti përkatës në ministri është në pozitën më të mirë për ta kryer hartimin dhe realizimin e vlerësimit, pasi e ka më të lehtë identifikimin e: palëve përgjegjëse për zbatimin e ligjit; qëllimit të ligjit; efekteve të mundshme; të dhënave në dispozicion; dhe praktikave aktuale tashmë të vendosura. Prandaj, është më e përshtatshme që ata t’a realizojnë analizën e aktit juridik dhe vlerësimin e procesit të miratimit të akteve nënligjore lidhur me aktin ligjor.
- **Departamenti Ligjor i ministrisë:** në parim, divizionet e mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit brenda departamentit ligjor të ministrisë janë në pozitë të duhur për t’u përkrahur dhe koordinuar procesin e vlerësimit Ex-Post. Në këtë drejtim, Departamenti Ligjor luan një rol të rëndësishëm edhe në përgatitjen e programit qeveritar të vlerësimit Ex-Post. Udhëheqësi/ja i/e Departamentit Ligjor i komunikon ZKM-së listën e akteve juridiketë propozuara nga ministria e tij/saj: ky propozim shoqërohet me një shënim të shkurtër shpjegues mbi arsyet se përse akti juridik është propozuar për një vlerësim ex-post, çështjet kryesore të vlerësimit (qëllimet, fushëveprimi i vlerësimit) dhe afatin kohor të vlerësimit që do t’i dërgohet Këshillit të Drejtorëve.
- **Mbikëqyrja nga Grupit Punues:** institucioni bartës i vlerësimit Ex-Post të caktuar themelon një grup punues të ngarkuar me hartimin e vlerësimit (definimi i fushëveprimit të vlerësimit, kriteret e vlerësimit, planit, etj.) në fazën fillestare të vlerësimit Ex-Post dhe me diskutimin e gjetjeve të vlerësimit Ex-Post në fazën përmbyllëse të vlerësimit.

#### Grupi Punues duhet të përbëhet nga:

1. Departamenti ligjor dhe departamenti përkatës/tematik i ministrisë përgjegjëse për vlerësimin Ex-post (si kryesues dhe bashkë-kryesues të grupit punues);
2. Departamentet tematike të ministrive të linjës të përfshira në zbatimin e aktit juridik, ose në fushën e përgjegjësisë që ndikohet nga akti juridik;
3. Përfaqësuesit e institucioneve dhe organeve të lidhura drejtpërdrejtë me zbatimin dhe realizimin e aktit juridik (p.sh agjencitë e inspektimit, autoritetet lokale, etj); dhe
4. Përfaqësuesit e mundur, duke marrë parasysh qëllimin e ligjit, përfaqësuesit e sektorit privat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile (të cilët mund të përfshijnë edhe përfaqësues të profesioneve të veçanta të prekura nga akti juridik).

### A.1.2. Promovimi dhe koordinimi i vlerësimit Ex-Post në nivel të qeverisë: ZL-ZKM dhe Këshilli i Drejtorëve

Me vendimin e Qeverisë caktohen funksione të rëndësishme të planifikimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes për palët e mëposhtme:

- **Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit (ZL-ZKM):** është përgjegjëse për koordinimin e punës me ministritë lidhur me planifikimin dhe koordinimin e vlerësimit Ex-Post të akteve juridike. Për këtë qëllim, ZL-ZKM harton programin Ex-Post dhe përcakton afatet përfundimtare të realizimit të vlerësimeve, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Drejtorëve (shih më poshtë). Në bazë të propozimeve të ministrive, programi vjetor përcakton të gjitha vlerësimet Ex-Post që do të bëhen gjatë vitit përkatës, duke përfshirë aktin juridik, institucionin përgjegjës që do t’a realizojë vlerësimin, afatet kohore dhe arsyetimin për përzgjedhjen e akteve përkatëse juridike. Pasi të përfundojë raportin e vlerësimit Ex-post, institucioni propozues duhet të sigurojë që gjetjet kryesore të vlerësimit Ex-Post të merren parasysh në mënyrën e duhur dhe kur është e nevojshme të pasqyrohen në procesin e planifikimit të ardhshëm legjislativ.
- **Këshilli i Drejtorëve:** Përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve Ligjore të të gjitha ministrive, dhe kryesohet nga Drejtori i Zyrës Ligjore në ZKM. Roli i Këshillit të Drejtorëve përfshin:
  - përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit qeveritar të vlerësimit Ex-Post të akteve juridike dhe të gjetjeve të vlerësimit;
  - ofrimin e këshillave për institucionet propozuese për zhvillimin e planit të vlerësimit;
  - shqyrtimin dhe finalizimin e programit të akteve juridike që do të vlerësohen sipas propozimit të institucioneve propozuese; dhe
  - shqyrtimin e progresit të realizimit të vlerësimeve *Ex-Post* nga institucioneve propozuese dhe nxjerrjen e një rekomandimit për procedimin të raportit të vlerësimit Ex-Post në Mbledhje të Qeverisë, apo rikthimin e tij te institucioni propozues për plotësim.

### A.1.3. Përfshirja e shoqërisë civile në vlerësimin Ex-Post

Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në procesin e realizimit të vlerësimit *Ex-Post* është me rëndësi thelbësore, siç është theksuar dhe kërkuar shprehimisht nga Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023).<sup>6</sup> Kjo strategji vlerëson konsultimin dhe pjesëmarrjen publike si një mjet të rëndësishëm për t’a bërë më gjithëpërfshirës informacionin rreth ndikimit socio-ekonomik të dispozitave ligjore që janë objekt i vlerësimit. Për më tepër, konsultimi me shoqërinë civile për zbatimin e dispozitave të aktit juridik dhe rezultateve të arritura mund të ndihmojë në identifikimin e shqetësimeve kryesore lidhur me aktin juridik dhe arsyet e mundshme për mos-zbatim ose zbatim jo të plotë të aktit. Shoqëria civile, varësisht nga fushëveprimi i aktit juridik që vlerësohet, mund të marrë pjesë edhe në grupet punuese të themeluara nga institucionet propozuese.

## Shtojca A.2. Si të përzgjedhet akti juridik për vlerësim Ex-Post?

Përzgjedhja e aktit juridik për vlerësim *Ex-Post* mund të bëhet në një nga situatat e mëposhtme:

- **Akti juridik ka një të ashtuquajtur “dispozite rishikimi/vlerësimi”** – në këtë rast është vetë akti juridik që e përmban

<sup>6</sup> Strategjia gjendet në [http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/02/Strategy\\_eng.pdf](http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/02/Strategy_eng.pdf).



detyrimin për ta kryer një vlerësim Ex-Post të plotë ose të pjesshëm. Zakonisht, dispozitat e tilla të rishikimit ose vlerësimit tregojnë qëllimin e vlerësimit dhe fushëveprimin e tij; kohën kur duhet të kryhet vlerësimi dhe detyrimin për të marrë për bazë gjetjet e vlerësimit Ex-Post për rishikimin ose shfuqizimin e mundshëm të dispozitave ligjore. Duhet pasur parasysh se jo të gjitha dispozitat e një akti juridik që kërkojnë kryerjen e një vlerësimi Ex-Post, janë dispozita rishikimi (shih Kutinë A.2.1).

#### Kutia A.2.1. Dispozitat e rishikimit që kërkojnë kryerjen e vlerësimit Ex-Post: Shembuj

Një dispozitë e një akti juridik që kërkon hartimin e një raporti nuk është dispozitë rishikimi ose vlerësimi. Për shembull, neni 14 i Ligjit për Kimikatet (Ligji Nr. 04/L-197) nuk përbën klauzolë vlerësimi pasi kërkon vetëm që qeveria ta hartojë një raport. Neni në fjalë përcakton:

*“1. Ministria harton raportin vjetor për gjendjen e kimikateve.*

*2. Raporti për kimikatet nga paragrafi 1 i këtij neni do të jetë pjesë e raportit për gjendjen mjedisore të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.*

*3. Raporti nga paragrafi 2 i këtij neni përmban kryesisht: të dhëna për llojet e kimikateve, informacion për lejet e lëshuara për kimikatet që prodhohen, importohen, eksportohen, informacione për kërkimet e kryera për kimikatet, informacione për laboratorët e akredituar dhe zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për menaxhimin e kimikateve.”*

Megjithatë, të dhënat e mbledhura në raport mund të japin një pasqyrë të dobishme për vlerësimin Ex-Post.

Në anën tjetër, shembujt e mëposhtëm të dispozitave ligjore përbëjnë dispozita të qarta rishikimi ose vlerësimi:

*“3. Komisioni duhet ta kryejë një vlerësim të ndërmjetëm të programit ISA<sup>7</sup> deri më 30 shtator 2019 dhe një vlerësim përfundimtar deri më 31 dhjetor 2021 dhe t’ia komunikojë rezultatet e këtyre vlerësimeve Parlamentit Evropian dhe Këshillit brenda të njëjtave data. Për këtë qëllim, komiteti ose komitetet përgjegjëse të Parlamentit Evropian mund ta ftojnë Komisionin t’i paraqesë rezultatet e vlerësimeve dhe t’u përgjigjet pyetjeve të ngritura nga anëtarët e tyre.*

*4. Vlerësimet e përmendura në paragrafin 3 duhet të shqyrtojnë, ndër të tjera, rëndësinë, efektivitetin, efikasitetin, dobinë, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, nivelin e kënaqshmërisë së bizneseve dhe qytetarëve, dhe qëndrueshmërinë dhe koherencën e veprimeve të programit ISA<sup>2</sup>. Vlerësimi përfundimtar, përveç kësaj, duhet ta shqyrtojë masën deri në të cilën programi ISA<sup>2</sup> i ka arritur objektivat e tij, si ripërdorimi i zgjidhjeve të ndërveprueshmërisë në të gjithë Bashkimin Evropian, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të shprehura nga administrata publike evropiane.*

Ose, neni 12 i Direktivës së BE-së 2015/2193:

*“1. Deri më 1 janar 2020, Komisioni duhet ta rishikojë progresin në lidhje me eficientësinë energjetike të impianteve me djegie mesatare dhe duhet t’i vlerësojë përfitimet e përcaktimit të standardeve minimale të efikasitetit të energjisë në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme. 2. Deri më 1 janar 2023, Komisioni duhet ta vlerësojë nevojën për t’i rishikuar dispozitat në lidhje me impiantet që janë pjesë e SIS ose MIS, si dhe Pjesën 2 të Shtojcës II, mbi bazën e teknologjive më të fundit.*

*Si pjesë e këtij rishikimi, Komisioni duhet gjithashtu ta vlerësojë nëse për disa ose të gjitha llojet e impianteve me djegie mesatare ekziston nevoja për t’i rregulluar emetimet e CO.*

*Më pas, rishikimi tjetër do të bëhet çdo dhjetë vjet dhe të përfshijë vlerësimin nëse është e përshtatshme të vendosen vlera kufitare më të rrepta të emetimeve, veçanërisht për impiantet e reja me djegie mesatare.*

*3. Komisioni duhet t’i paraqesë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport mbi rezultatet e rishikimeve të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të shoqëruar me një propozim legjislativ aty ku është e nevojshme.”*

Nëse aktet juridike nuk përmbajnë dispozita ligjore të cilat krijojnë detyrimin për t’u realizuar vlerësim Ex-Post për një akt juridik specifik, megjithatë institucioni propozues mund të përzgjedhin aktin juridik për vlerësim Ex-Post duke marrë për bazë situatat e mëposhtme:

- **Akti juridik ka ndikime të rëndësishme në ekonomi, shoqëri, mjedis, apo sektorin publik** – kjo i referohet madhësisë së ndikimeve (p.sh. madhësia e sektorit ekonomik të shprehur në përqindje të PBB-së, numri i bizneseve të prekura, shumata e fondeve publike të investuara, etj) ashtu dhe dinamikës së ndryshimeve të shkaktuara nga ndërhyrja legjislative (p.sh. lloji dhe numri i degëzimit të ndryshimeve të gjeneruara në zinxhirin e rezultateve). Në parim, sa më të rëndësishme të jenë ndikimet, aq më tepër duhet t’i jepet prioritet përzgjedhjes së aktit juridik për vlerësim Ex-Post. Më tej, përmbajtja dhe informacioni i përshkruar në Koncept Dokumente mund të ofrojë udhëzime të rëndësishme në përzgjedhjen e vlerësimit Ex-Post. Përveç kësaj, institucioni propozues mund t’a vlerësojë rëndësinë e një akti juridik për vlerësim Ex-Post edhe nga çfarë është përcaktuar si qëllimi final i aktit juridik si dhe nga buxheti i ndarë për të.
- **Vështirësitë e theksuara gjatë zbatimit të aktit juridik tashmë janë identifikuar** – një mënyre tjetër që mund t’a arsyetojë përzgjedhjen e një akti juridik për vlerësim Ex-Post është evidentimi i ngecjeve në procesin e zbatimit të aktit juridik. Një informacion i tillë mund të vijë nga njoftimet nga institucionet zbatuese (p.sh. inspektoratet). Në një rast të tillë, është e përshtatshme të kryhet një Vlerësim i Zbatimit dhe Pajtuashmërisë si një vlerësim parësor për t’a identifikuar se ku qëndrojnë problemet – për shembull, a është problemi te hartimi i ligjit ose te diskrecioni me të cilin palët e interesuara e respektojnë aktin juridik ose tek inspektorët që zbatojnë atë akt – për t’a shmangur zbarzëtimin ligjor, dështimet rregullatore (p.sh. një dispozitë e paqartë, rasti i kolizionit ligjor etj), pasojat e padëshiruara dhe dëmet e mundshme të pakthyeshme.
- **Komentet përkatëse që ofrohen nga palët e interesuara** – ky është një mjet që përdoret gjithnjë e më shumë në praktikën e vendeve të ndryshme dhe përbëhet nga kërkesat apo pyetjet e drejtuara nga palët e interesuara dhe përdoruesit përfundimtarë (p.sh. konsumatorët, qytetarët etj.) të cilat i identifikojnë ose specifikojnë aktet juridike që, sipas tyre, krijojnë probleme ose mund të përmirësohen. Në këtë aspekt, duhet t’i kushtohet vëmendje e duhur komenteve të ofruara nga palët e interesuara që përfaqësojnë shoqërinë civile, dhe në veçanti interesat gjinore, të rinjve dhe grupeve të ndjeshme, gjatë përcaktimit të aktit juridik për

<sup>7</sup> ISA<sup>2</sup> është një program financimi i Bashkimit Evropian që mbështet zhvillimin e zgjidhjeve dixhitale, të cilat u mundësojnë administratave publike, bizneseve dhe qytetarëve në Evropë të përfitojnë nga shërbimet publike ndërkufitare dhe ndërsektorale të ndërveprueshme.

vlerësimin *Ex-Post*.<sup>8</sup> Natyrisht, jo të gjitha sugjerimet për vlerësim janë të rëndësishme apo të arsyetuara: prandaj, çdo institucion propozues ka përgjegjësinë t'i shqyrtojë propozimet dhe të vendosë nëse do t'i përfshijë në vlerësimin *Ex-Post* dhe deri në çfarë mase. Shpeshherë, palët e interesuara ftohen të rekomandojnë aktet juridike për vlerësim *Ex-Post* me synimin për t'a thjeshtuar kornizën ligjore, procedurën administrative dhe për t'i minimizuar kostot administrative dhe rregullatore.<sup>9</sup>

- **Akti juridik hyn në një program të gjerë rishikimesh sektoriale** – në fund, përzgjedhja për kryerjen e vlerësimit *Ex-Post* të një akti juridik, mund të diktohet nga një strategji më e gjerë vlerësimi shumëvjeçare që përfshin sektorë të veçantë të ekonomisë ose politika specifike (p.sh. vlerësimi i kornizës ligjore që ndikon në industrinë metalike në Kosovë; ose rishikimi i akteve juridike që rregullojnë përfshirjet sociale të grupeve të ndjeshme).

Afati kohor i kryerjes së vlerësimit është një faktor vendimtar që ndikon në përdorimin e vlerësimit në procesin e vendimmarrjes. Në mënyrë që gjetjet të jenë relevante dhe të përdoren nga vendimmarrësit, planifikimi dhe realizimi i vlerësimit *Ex-Post* duhet të përputhen me prioritetet politike dhe programit e vlerësimit *Ex-Post*.

Përveç kësaj, vlerësuesi duhet t'a ketë parasysh se ndërhyrjet rregullatore si ligjet dhe aktet nënligjore kanë cikle shumë të ndryshme. Në disa raste, shfaqja e rezultateve të synuara nga aktet juridike mund të kërkojë disa vite për t'u shfaqur dhe po ashtu nuk shfaqen në mënyrë lineare (pra, nuk shfaqen në mënyrë të njëpasnjëshme sipas zingjirit të rezultateve). Varësisht nga situatat, palëve të ndryshme të interesuara mund t'u jepen periudha më të gjata ose më të shkurtra për t'i përmbushur kërkesat ligjore (p.sh. përmes dispozitave të rishikimit). Për këto arsye, vlerësimi *Ex-Post* nuk mund të fillohet derisa të kalojë një kohë e konsiderueshme nga hyrja në fuqi e aktit juridik. Planifikimi i vlerësimit vështirësohet nëse një ndërhyrje e caktuar rishikohet shumë shpesh.

Siç theksohet në tekstin kryesor të Manualit, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në dispozitat e rishikimit të detyrueshëm, institucioni propozues nuk duhet të fillojë t'a kryejë një Vlerësim të Zbatimit dhe Pajtueshmërisë pa kaluar një vit nga hyrja në fuqi e aktit juridik. Për vlerësimin e ndikimit, kjo periudhë në përgjithësi duhet të jetë të paktën tre vjet nga hyrja në fuqi e aktit juridik. Në mënyrë që të përgatitet mirë, institucioni propozues duhet t'a fillojë planifikimin e vlerësimit sa më shpejt të jetë e mundur me fillimin e zbatimit, së bashku me organizimin e procesit të monitorimit.

Institucioni propozues gjithashtu duhet të planifikojë kohë shtesë nëse ka vendosur t'a kontrakttojë tërë vlerësimin *Ex-Post* apo një pjesë të tij. Hartimi i Termave të Referencës, zhvillimi i procedurës së prokurimit publik si dhe përzgjedhja e ekspertëve të jashtëm kanë një ndikim të rëndësishëm në kohëzgjatjen e punës së vlerësimit, prandaj institucioni propozues ose grupi punues i themeluar për realizimin e vlerësimit *Ex-Post* duhet t'a ketë parasysh këtë kur bën planifikimin për vlerësimin.

### Shtojca A.3. Analiza e palëve të interesuara për vlerësimin *Ex-Post*

Palë relevante për vlerësimin *Ex-Post* janë individët, grupet ose organizatat që preken nga akti juridik cili është objekt i vlerësimit; ata që janë të përfshira në zbatim të aktit juridik; dhe ato/ata që posedojnë informacion, burime dhe ekspertizë të nevojshme për kryerjen e vlerësimit.

Përderisa palët kryesore të një politike ose sektori mund të jenë të njohur mirë, është e rëndësishme që të identifikohet dhe të përshtatet lista e palëve të interesuara me aktin juridik dhe vlerësimin konkret. Përveçse është një parakusht i parimit “*të mos lëmë askënd prapa*” sipas Agjendës 2030 (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm),<sup>10</sup> identifikimi i duhur i palëve të interesuara është me rëndësi sepse realiteti në terren është i komplikuar: nisma të ndryshme në të njëjtin sektor mund të kenë

<sup>8</sup> Në përputhje me Strategjinë e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023).

<sup>9</sup> Disa vende kanë krijuar platforma të dedikuara online të hapura ndaj ideve për vlerësim nga palët e interesuara – shihni për shembull faqen e internetit të Komisionit Evropian “Lighten the Load” ([https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/lighten-load\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/lighten-load_en)); ose uebsajti i Sfidimit të Burokracisë në Mbretërinë e Bashkuar (<https://www.gov.uk/government/news/red-tape-challenge>).

<sup>10</sup> Cfr. gjithashtu, në këtë drejtim, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023).

palë kryesore të ngjashme/të përbashkëta, por ndikimet konkrete dhe çështjet e zbatimit mund të prekin edhe palë shtesë që gjithashtu duhet të identifikohen dhe të trajtohen. Rrjedhimisht, grupi punues duhet t'i kushtojë vëmendje të duhur palëve të sektorit privat, si dhe grupeve përkatëse të shoqërisë, siç janë gratë, të rinjtë dhe grupet e ndjeshme.

Analiza e palëve të interesuara ndjekë tre hapa kryesorë: (1) identifikimi; (2) klasifikimi; dhe (3) angazhimi i palëve.

#### A.3.1. Identifikimi i grupeve të palëve të interesuara

Hapi i parë në analizën e palëve të interesuara është identifikimi i palëve të interesuara. Kategoritë kryesore të palëve të interesuara janë renditur në tabelën e mëposhtme.

##### Kategoritë e palëve të interesuara (lista jo e plotë):

Individët	Personat individualë– për shembull gratë, të rinjtë apo grupet vulnerable.
Sektori privat	Ndërmarrjet e mëdha NVM-të dhe Mikrondërmarrjet Të vetëpunësuarit Odat ekonomike Organizatat e biznesit Kompanitë që ofrojnë konsulencë profesionale
Organizatat joqeveritare	Sindikatat Organizatat e shoqërisë civile Rrjetet e grupeve të caktuara Organizatat religjioze
Hulumtimi dhe akademja	Institucionet kërkimore Institucionet akademike
Autoritetet publike	Autoritetet lokale Qeveria e Kosovës dhe agjencitë e saj Kuvendi i Kosovës dhe agjencitë e tij Institucione dhe organe të tjera kombëtare Qeveritë dhe institucionet e huaja Institucionet dhe organet e BE-së Organizatat ndërkombëtare

Identifikimi i palëve të interesuara mund të bëhet nga një qasje e strukturuar. Për të qenë sa më gjithëpërfshirës, është e dobishme të mbështeteni në konsultimet publike përkatëse në të kaluarën; dokumentet e politikave, të tilla si koncept dokumenti; dhe vërejtjet e mediave.

### A.3.2. Klasifikimi i palëve të interesuara

- Hapi i dytë i analizës së palëve të interesuara është **klasifikimi i palëve të interesuara** që janë identifikuar. Kjo përbëhet nga
- Dallimi i grupeve të palëve të interesuara që mund të ndikohen dukshëm nga akti juridik (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë) dhe përcaktimi i nivelit të ndikimit të këtyre grupeve;
  - Diferencimi i mundësive të ndryshme në të cilat palët e interesuara preken brenda një grupi të caktuar p.sh. varësisht nga madhësia, vendndodhja, lloji i aktivitetit ose karakteristikat e tjera; dhe
  - Përcaktimi se si palët të ndryshme të interesit mund të ndikojnë në politikëbërjen dhe vlerësimin e saj.

Tutje, Komisioni Evropian sugjeron përdorimin e një “liste kontrolli me gjashtë teste” për t’a lehtësuar identifikimin dhe klasifikimin e palëve të interesuara:<sup>11</sup>

#### Testi 1 Kush ndikohet drejtpërdrejtë?

Jeta ditore/javore e kujt do të ndryshojë si rezultat i zbatimit të aktit juridik?

A ka efekte specifike në grupe të veçanta (të përcaktuara sipas moshës, gjinisë, aftësive të kufizuara, pakicave të përkatësisë etnike ose racore, grupit social, lëvizshmërisë, rajonit, etj.)? Kush do të duhet t’a ndryshojë sjelljen si rezultat i aktit juridik?

#### Testi 2 Kush ndikohet tërthorazi?

Jeta e përditshme e kujt do të ndryshojë kur të tjerët janë ndikuar drejtpërdrejt nga akti juridik?

Kush do të fitojë ose humbë për shkak të ndryshimeve që rezultojnë nga akti juridik?

#### Testi 3 Kush është i ndikuar potencialisht?

Në rrethana të veçanta, kush do të ketë një ndikim të ndryshëm si rezultat i aktit juridik?

A ka individë apo grupe që do të duhet t’a rregullojnë sjelljen e tyre nëse zbatohen kushte të veçanta?

#### Testi 4 Ndhurma e kujt nevojitet?

Kush do t’a ketë aftësinë për t’a penguar zbatimin e aktit juridik nëse nuk bashkëpunon me akterët e duhur?

Kush e kupton ndikimin e mundshëm të aktit juridik te palët e tjera të interesuara?

#### Testi 5 Kush mendon se di për këtë temë?

Kush e ka studiuar këtë temë dhe ka publikuar pikëpamje mbi të?

Kush ka njohuri të hollësishme lidhur me aktin juridik?

A ka individë apo grupe që perceptohen si të “dijsëm” mbi këtë temë?

#### Testi 6 Kush do të ketë interes për këtë temë?

A ka organizata apo individë që mendojnë se kanë interes në këtë temë?

A ka bërë dikush fushatë për këtë çështje?

A publikon apo transmeton ndokush pikëpamje mbi këtë temë?

Për t’a realizuar vlerësimin *Ex-Post* bazuar në prova, çështjet që lidhen me të drejtat themelore të njeriut duhet të trajtohen gjatë fazave të hershme përgatitore të hartimit të vlerësimit. Konsultimi dhe angazhimi i palëve të interesuara duhet të

<sup>11</sup> Përshtatur nga Kutia e mjeteve për rregullim më të mirë të Komisionit Evropian, “Mjeti #52. Strategjia e Konsultimit”, e disponueshme në: [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br\\_toolbox-nov\\_2021\\_en\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br_toolbox-nov_2021_en_0.pdf).

përfshijë, kurdoherë që është e mundur dhe e përshtatshme, mbledhjen e të dhënave të ndara në lidhje me ndikimet e mundshme në të drejtat themelore, të tilla si përfshirja dhe barazia sociale dhe gjinore, si dhe mbrojtja e personave të cenueshëm në shoqëri. Konkretisht, kjo do të thotë të kontrollohet nëse akti juridik ka krijuar (ose nuk ka arritur të mënjanojë) situata në të cilat disa pjesë të shoqërisë përjetojnë pabarazi në bazë të gjinisë ose orientimit seksual, origjinës etnike dhe racore, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, etj.

Kutia A.3.1. ofron një listë të shkurtër të pyetjeve kryesore që kanë të bëjnë me çështjet e pabarazisë në vlerësimin Ex-Post.

#### Kutia A.3.1. Trajtimi i pabarazisë sociale në vlerësimin Ex-Post: Pyetjet kyçe

A ka pasur akti juridik (drejtpërdrejt ose tërthorazi) ndikim të ndryshëm tek personat e ndryshëm si gratë, të rinjtë apo personat me nevoja të veçanta? A është ky rezultat i dëshiruar i aktit juridik apo është pasojë e padëshiruar?

A e ka promovuar akti juridik barazinë ndërmjet personave të ndryshëm? Pse? Si?

A ka kontribuar akti juridik në luftimin e diskriminimit të grupeve të veçanta si personat me prejardhje etnike nga komunitetet jo-shumicë (duke përfshirë romët), komunitetet fetare, personat nga komuniteti LGBTI, fëmijët, të moshuarit ose personat me aftësi të kufizuara?

Shpërndarja e të ardhurave, mbrojtja sociale dhe përfshirja mund të trajtohen edhe duke parashtruar nën-pyetjet e tilla si:

- A ka ndikuar akti juridik në nivelin e të ardhurave apo pasurisë së njerëzve/familjeve të ndryshme, shpërndarjen e të ardhurave apo rregjikon e varfërisë?
- A ka ndikuar akti juridik në qasjen dhe cilësinë e përfitimeve të mbrojtjes sociale, duke përfshirë shërbimet sociale, veçanërisht për ata që janë nën rregjikon e përjashtimit social?
- A ka ndikuar akti juridik në qasjen dhe cilësinë në mallra dhe shërbime thelbësore, duke përfshirë arsimin, veçanërisht për ata që janë nën rregjikon e përjashtimit social?

*Burimi: Përshtatur nga Kutia e Veglave për Rregullim më të Mirë e Komisionit Evropian, “Mjeti #29. Të Drejtat Themelore, Përfshirë Promovimin e Barazisë”, DHE “Mjeti #30. Punësimi, Kushtet e Punës, Shpërndarja e të Ardhurave, Mbrojtja Sociale dhe Përfshirja”, mund të gjenden në: [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br\\_toolbox-nov\\_2021\\_en\\_0.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br_toolbox-nov_2021_en_0.pdf).*

Tutje, e ashtuquajtura “**Matrica e palëve të interesuara**” është një mjet efektiv që mundëson klasifikimin dhe kategorizimin e palëve të interesuara dhe pozicionin e tyre përballë problemit ose aktit juridik në shqyrtim. Matrica rezulton në një sërë fazash, duke filluar me kërkimin e:

- interesave të palëve të ndryshme në lidhje me problemin e identifikuar
- burimeve në dispozicion të tyre, p.sh. në lidhje me atë që mund të silltet në debat për çështjen konkrete
- aftësinë e tyre për t’i mobilizuar burimet, dhe
- qëndrim zyrtar/publik në lidhje me aktin juridik në fjalë

Një tabelë e mundshme mund të duket si më poshtë:

Pala e interesit	Interesi / Përfitimi ose Humbja	Burimet e disponueshme	Kapaciteti për t'i mobilizuar burimet	Pozicioni zyrtar
Organizata A				
Organizata B				
....				

Qëllimi është të vlerësohet niveli i interesit (ndikimi) dhe influenca e secilës palë të interesuar, në mënyrë që të planifikohet përshtatshëm angazhimi i tyre për t'a ndihmuar vlerësimin *Ex-Post*. Kjo mund të bëhet, për shembull, duke bërë përpjekjet e nevojshme për të arritur tek palët relevante, por që nuk janë të organizuara mirë ose janë më pak të dukshme në shoqëri.

Për t'a identifikuar **nivelin e interesit (ndikimit)** mund të parashtrihen pyetjet e mëposhtme udhëzuese:

- Sa afër është çështja me palën e interesuar (testi i afërsisë)?
- Nëse një takim do të mbahej sot, sa e dukshme do të ishte pala në agjendën e palëve të interesuara (testi i agjendës)?
- Cila është historia e përfshirjes së palëve të interesuara në këtë çështje?
- Sa nga anëtarët aktivë të palëve të interesuara preken drejtpërdrejtë?
- Në 'rastin më të keq' sa mund të ndikohen palët e interesuara?

Për ta identifikuar **nivelin e influencës** mund të përdoren pyetjet e mëposhtme udhëzuese:

- A i jep statusi i palës së interesuar asaj ndonjë legjitimitet apo rëndësi të veçantë (testi i statusit)?
- A konsiderohet udhëheqja e palës së interesuar me ndikim personal (testi VIP)?
- A ka dëshmi se kjo palë e interesuar ka ndjekje të gjerë popullore?
- Sa efektive janë palët e interesuara në përdorimin e marrëdhënieve me shtypin ose teknologjinë e re për t'i bërë të ditura pikëpamjet e tyre?
- Cili është historiku i palëve të interesuara?
- A i kanë bindur palët e interesuara me sukses vendimmarrësit në të kaluarën?

Si rezultat, mund të zhvillohet një matricë me katër kuadrate, e cila e vendos kapacitetin e grupeve të ndryshme të palëve të interesuara në mënyrë strategjike në raport me mbledhjen e të dhënave për vlerësimin *Ex-Post*:

	Kapacitet i lartë për vetë-mobilizim	Kapacitet i ulët për vetë-mobilizim
Ndikim i lartë	PARTNERËT (Dialogoni, përfshini)	TË PADUKSHME (Duhet të angazhoheni aktivisht me ta / ta ndihmoni pjesëmarrjen e tyre)
Ndikim i ulët	PALET E INTERESUARA (Këshilloni)	PUBLIKU (Informoni)

### A.3.3. Organizimi i angazhimit të palëve të interesuara

Angazhimi efektiv me palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme mund t'a rrisë ndjeshëm besueshmërinë e një vlerësimi *Ex-Post*. Duke siguruar që perspektivat e ndryshme të diskutohen, analizohen dhe raportohen, përfshirja të gjitha palëve përkatëse në procesin e vlerësimit, ndihmon në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit *Ex-Post*, sigurimin e përputhshmërisë me politikën e tjera dhe demonstrimin e një qasjeje të hapur dhe transparente për t'a analizuar në mënyrë kritike performancën e e aktit juridik.

Përfshirja e palëve të interesuara gjithashtu ndihmon në parashikimin (dhe zgjidhjen) e problemeve që mund të shfaqen më vonë gjatë procesit (p.sh. në përcaktimin e masave të mundshme pasuese nga gjetjet e vlerësimit). Palët e ndryshme dhe ekspertët janë në pozitë të mirë për t'a testuar nëse argumentet dhe deklaratat e bëra në vlerësimin e caktuar *Ex-Post* janë të qarta dhe të lehta për t'u ndjekur.

Kur planifikohet një vlerësim *Ex-Post*, një listë kontrolli me pyetje kyçe ndihmon në kuadrin e angazhimit të palëve të interesuara (shih Kutinë A.3.2.).

#### Kutia A.3.2. Planifikimi për angazhimin e palëve të interesuara në vlerësimin *Ex-Post*

Pyetjet e mëposhtme janë pjesë e Planit të Vlerësimit kur bëhet fjalë për identifikimin e palëve të interesuara përkatëse të vlerësimit *Ex-Post* dhe organizimin e angazhimit të tyre gjatë procesit të vlerësimit:

- **Kush duhet të përfshihet në procesin e vlerësimit?** – Përgjigja: jo të gjithë sektorët e ekonomisë, nën-grupet e popullsisë apo zonat gjeografike janë të prekur njësoj. Prandaj, është me rëndësi të bëhet saktë identifikimi i palëve të interesuara.
- **Pse duhet të angazhohen ata/ato?** – Përgjigja: kjo bëhet më e qartë kur përgatitet "matrica" që i dallon palët e interesuara për sa i përket interesave të tyre; kapaciteteve; rëndësisë; dhe ndikimit.
- **Me çfarë duhet të angazhohen ata/ato?** – Përgjigja: mund të jetë në një segment specifik të vlerësimit, për t'i testuar idetë konceptuale (logjika e ndërhyrjes) ose për të kërkuar të dhëna/inpute të mëtejme. Vlerësuesi duhet t'i formulojë arsyet e tij/saj dhe qëllimet e konsultimit.
- **Si do të angazhohen ata/ato?** – Përgjigja: shumë forma dhe mjete të ndryshme janë në dispozicion, varet nga palët e interesuara; faza e vlerësimit; dhe burimet në dispozicion. Shpesh, një përgjigje e qasjeve është e dëshirueshme. Ndihmon nëse përdoret gjuhë e thjeshtë.
- **Kur duhet të angazhohen ata/ato?** – Përgjigja: sa më shpejt që të jetë e mundur, kur Plani i Vlerësimit të finalizohet dhe grupi punues t'a ketë kuptuar mjaftueshëm se çfarë informacioni kërkon nga palët të ndryshme.
- **Si të përdoren inputet e tyre?** – Përgjigja: është thelbësore të komunikohet në kohë dhe qartë niveli i angazhimit, duke raportuar në mënyrë transparente për arsyet pse kontributet e disa palëve të interesuara janë pranuar dhe të tjera jo.



## Shtojca A.4. Llojet e vlerësimit

Kjo shtojcë përshkruan më në detaje llojet e vlerësimit dhe ofron udhëzime për t'i zbatuar ato në vlerësimin *Ex-Post*.

### A.4.1. Vlerësimi i zbatimit dhe Pajtueshmërisë

Vlerësimet e Zbatimit dhe Pajtueshmërisë janë lloji i parë i vlerësimit. Ato duhet të japin përgjigje nëse akti juridik është zbatuar dhe nëse palët kanë vepruar konform tij. Po ashtu, duhet të vlerësojnë rastet e dështimit të zbatimit, arsyet e vonesave ose mos zbatimit.

Nëse një Vlerësim i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë tregon se akti juridik nuk është zbatuar, kjo do të thotë se akti nuk i ka dhënë rezultatet e synuara. Në këtë rast, nuk ka nevojë të vazhdohet me Vlerësimet e Performancës ose të Ndikimit.

#### Pyetjet kyçe:

Disa nga pyetjet e përgjithshme që duhet të përgjigjen gjatë Vlerësimit të Zbatimit dhe Pajtueshmërisë janë:

#### Pajtueshmëria:

- A janë nxjerrë aktet nënligjore që derivojnë nga ligji?
- A është ndarë buxheti i planifikuar për zbatimin e aktit juridik?
- Sa i avancuar është zbatimi i aktit juridik?
- Cilat janë vështirësitë në zbatimin e aktit juridik?

#### Efikasiteti:

- Sa ka kushtuar procesi i zbatimit të aktit juridik?
- A ka hapësirë për t'a thjeshtuar zbatimin dhe për t'i kursyer resurset (paratë, personeli, ...)?

### A.4.2. Vlerësimi i Performancës

Ky është lloji i dytë i vlerësimit i cili analizon progresin përgjatë zinxhirit të rezultateve. Ndonëse vlerësimi i performancës mund të mos vlerësojë manifestimin dhe madhësinë e plotë të ndikimeve përfundimtare, ky lloji i vlerësimit i lejon grupit punues të kuptoj drejtimin e ndryshimit dhe t'a shpjegojë atë ndryshim bazuar në dëshmi. Vlerësimi i Performancës ofron një përshkrim të përgjithshëm të marrëdhënies ndërmjet ndërhyrjes (aktit juridik) dhe efekteve të ndryshme të saj.

Grupi punues duhet të jetë i vetëdijshëm se sa më shumë faktorë ose lidhje të ekzistojnë në zinxhirin e rezultateve (nga një hallkë e zinxhirit të rezultateve në tjetrën), aq më shumë ka gjasa që të ketë një sërë shpjegimesh të mundshme për çdo ndryshim të observuar.

Grupi punues duhet të mbledhë dëshmi përmes metodave sasiore dhe cilësore të mbledhjes së të dhënave për marrëdhëniet shkak-pasojë ndërmjet aktiviteteve dhe produkteve brenda zinxhirit të rezultateve; ndërmjet produkteve dhe të rezultateve,

dhe ndërmjet rezultateve dhe ndikimit për të pretenduar se akti juridik ka kontribuar në arritjen e rezultatit përfundimtar të synuar (d.m.th. është arritur ndikimi).

Nëse konstatohet se të gjithë hapat në zinxhirin e rezultateve funksionojnë siç është parashikuar (d.m.th., akti juridik zbatohet siç është paraparë; pjesëmarrësit e ndryshojnë sjelljen e tyre siç është paraparë; dhe rezultatet e dëshiruara janë realizuar), kjo e rrit konsistencën e përgjithshme të gjetjeve të vlerësimit. Megjithatë, mund të ketë raste kur disa hapa nuk mund të vërtetohen plotësisht. Për shembull, nëse të gjithë hapat në zinxhirin e rezultateve shihet se kanë funksionuar siç pritej, por ka dëshmi të dobëta të ndikimit përfundimtar, në raste të tilla, konfirmimi i hapave të mëparshëm në modelin logjik do të shpie në rritjen e besimit se akti juridik ka pasur ndikim të dëshiruar. Megjithatë, nëse grupi punues nuk mund të sigurojë prova të mjaftueshme në një nga segmentet e zinxhirit të rezultatit (qoftë për zbatimin e aktit juridik, ose midis zbatimit të aktit juridik dhe produktit ose midis produktit dhe rezultatit dhe midis rezultateve të ndryshme), atëherë nuk mund të pretendojë se ka pasur ndonjë kontribut në ndryshimet pozitive të realizuara në rezultatit përfundimtar të synuar (tek ndikimi final).

#### Pyetjet kyçe:

Disa nga pyetjet e përgjithshme që Vlerësimi i Performancës duhet të përpiqet t'u japë përgjigje:

#### Relevanca:

- A është qëllimi i përgjithshëm i aktit juridik ende i vlefshëm dhe relevant në raport me problemin fillestar?
- A e arsyeton gjendja aktuale e situatës ekzistencën e aktit juridik?

#### Koherenca:

- A ka konsistencë ndërmjet aktit juridik dhe masave të tjera politike apo ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe traktateve, marrëveshjeve dhe standardeve ndërkombëtare?

#### Ndikimi:

- Cilat janë qëllimet e aktit juridik? A ka pasur ndryshime pozitive të observuara drejt arritjes së këtij qëllimi?

#### Efektiviteti:

- Cilat janë efektet e drejtpërdrejta nga zbatimi i aktit juridik?
- A janë arritur produktet, rezultatet dhe ndikimi?
- A ka efekte të veçanta të shpërndarjes?
- A ka ndonjë efekt anësor të padëshiruar?

#### Efikasiteti:

- Deri në çfarë mase kanë pasur kosto efektive burimet njerëzore, materiale dhe financiare të investuara për t'i arritur rezultatet?
- A do të arriheshin rezultate më të mira me rialokimin e këtyre burimeve?
- Kur një akt juridik mund të zbatohet në disa mënyra, cila është mënyra më efikase apo me kosto më të ulët?

#### Qëndrueshmëria:

- Sa i qëndrueshëm është zbatimi i aktit juridik?
- Sa të qëndrueshme janë ndikimet?

### A.4.3. Vlerësimi i Ndikimit

Vlerësimi i Ndikimit analizon:

1. nëse qëllimet e përcaktuara të aktit juridik (ndikimet përfundimtare) - ose rezultatet e përcaktuara përmes logjikës së ndërhyrjes janë arritur, dhe
2. shkallën deri në të cilën këto ndryshime/rezultate mund t'i "atribuohen" vetë aktit juridik. Është kjo pika e dytë – vendosja e atribuimit, d.m.th. kauzaliteti drejtpërdrejt –tipari përcaktues i vlerësimit të ndikimit.

Atribuimi i referohet konkludimit empirik në lidhje me atë se deri në çfarë mase akti juridik i ka shkaktuar me të vërtetë ndonjë nga ndryshimet e konstatuara. Se sa mund të realizohet kjo qasje, varet kryesisht nga matshmëria e rezultatit si dhe mundësia për t'a vlerësuar çfarë do të kishte ndodhur në mungesë të aktit juridik. Për këtë qëllim, vlerësuesi duhet të vendosë një kundërfakt duke krijuar të ashtuquajturat "grupe krahasimi (ose kontrolli)". Prandaj, Vlerësimi i Ndikimit kërkon gjetjen e një ose më shumë grupesh krahasimi për të vlerësuar se çfarë ka ndodhur me grupin e kontrollit (që nuk i nënshtrohet kërkesave të aktit juridik), dhe më pas të bëhen krahasime me grupin që i është nënshtuar atyre kërkesave të aktit juridik – shih Kutinë A. 1.

#### Kutia A.1. Analiza atributive

Një shembull i zakonshëm (jo domosdoshmërisht juridik) i analizës së atribuimit është eksperimenti i barërave mjekësore ku një grup pjesëmarrësish (grupi i "trajtimit") merr një ilaç të ri dhe tjetri (grupi "krahasues" ose "kontrolli") merr një placebo ose merr një ilaç pa ndonjë përbërje. Përcaktimi i pjesëmarrësve të eksperimentit në të dy grupet zakonisht është i rastësishëm. Për sa kohë që grupet e trajtimit dhe të kontrollit janë të ngjashme dhe të barabarta në të gjitha aspektet e tjera përkatëse, ato mund të shërbejnë si krahasues për njëri-tjetrin. Nëse ka ndonjë ndryshim në rezultatet e konstatuara midis të dyve, mund të supozohet (sipas supozimeve të caktuara teknike) se ndryshimi është për shkak të trajtimit ose ilaçit. Në këtë shembull, trajtimi është medikamenti i testuar, ndërsa në vlerësimin Ex-Post trajtimi është akti juridik.

Në disa zinxhirë rezultatesh, marrëdhënia "shkak-pasojë" mund të jetë mjaft e thjeshtë dhe transparente sa që ndryshimi të mund të vërehet drejtpërdrejt, pa pasur nevojë të kontrollohen kundër faktorët. Në ato raste, nuk ka nevojë të krijohen dy ose më shumë mostra ose grupe të dhënash ekuivalente ose të ngjashme. Për shembull, me një projekt për furnizimin me ujë të një fshati në një vend në zhvillim, çdo rënie e vërejtur në kohën mesatare që anëtarët e familjes shpenzojnë për bartjen e ujit për nevojat e veta mund t'i atribuohet projektit pa pasur nevojë për ndonjë grup krahasimi.

Përfitimi kryesor i Vlerësimit empirik të Ndikimit është që mundëson të izolohehen efektet e intervenimit (d.m.th. aktit juridik) nga shumëllojshmëria e mundshme e faktorëve që mund të ndikojnë në rezultatin e shqyrtuar. Në këtë mënyrë, Vlerësimi i Ndikimit mund të japë një testim (vlerësim) rigoroz të asaj nëse intervenimi (akti juridik) ka pasur efekt apo jo.

Vlerësimi Empirik i Ndikimit megjithatë nuk është i realizueshëm për secilin vlerësim politikash apo akti juridik. Një sfidë kryesore të Vlerësimit i Ndikimit është ndërtimi i një grupi krahasimi që është sa më i ngjashëm me grupin e trajtimit. Krijimi i grupeve të krahasimit, është edhe më e vështirë kur vlerësohen aktet juridike, pasi kërkesat ligjore zakonisht zbatohen në mënyrë të njëjtë në tërë ekonominë dhe shoqërinë dhe nuk ka shumë gjasa që të ketë një grup krahasimi të disponueshëm që nuk i është nënshtuar atyre kërkesave aktit juridik.

Mënyra për krijimin e kundër-fakteve (kundërfaktual)<sup>12</sup> në kontekstin e vlerësimit *Ex-Post* të akteve juridike është të shfrytëzohen nëse është e mundur variacionet, duke krahasuar rezultatet në momentet ose vendet ku akti juridik është miratuar me rezultatet në kohë ose vende të tjera ku akti juridik nuk është miratuar. Vlerësimi i Ndikimit vlerëson gjithashtu nëse ka ndodhur ndonjë rezultat ose ndikim, i cili nuk ishte menduar fillimisht, dhe nëse po, çfarë e ka shkaktuar shfaqjen e një rezultati ose ndikimi të tillë dhe sa i rëndësishëm është ai.

Edhe nëse mund të përcaktohet një grup krahasimi, kryerja e Vlerësimit të Ndikimit do të ishte e vështirë nëse rezultatet e shaktuara ndryshojnë për grupin e trajtimit për shkak të mënyrës së përzgjedhjes së grupit dhe jo për shkak të vetë aktit juridik. Në një rast të tillë, krahasimi do të ishte çorientues. Ky problem njihet si "paragjykim i përzgjedhjes" së grupit. Në këtë situatë, nuk do të jetë e mundur të thuhet nëse ndryshimet në rezultatet e vëzhguara midis dy grupeve janë për shkak të aktit juridik apo diçkaje tjetër. Hartimi i vlerësimit të Ndikimit kërkon të kontrollohet përbërja e grupit të krahasimit në mënyrë që paragjykimet e përzgjedhjes ose të shmangen ose të trajtohen. Për këtë qëllim, vlerësuesit e ndikimit kryejnë "eksperimente të rastësishme" ose "kuazi-eksperimente" (edhe pse ndonjëherë rastësia "natyrore" mund të përdoret në vend të saj).<sup>13</sup>

Vlerësimi i Ndikimit mund të ndahet më tej në dy kategori: prospektive dhe retrospektive. Vlerësimet prospektive të ndikimit zhvillohen në të njëjtën kohë kur hartohet akti juridik. Të dhënat bazë mblidhen përpara se akti juridik të zbatohet si për grupin që i nënshtrohet aktit juridik ashtu edhe për grupin e krahasimit. Vlerësimet retrospektive vlerësojnë ndikimet pas zbatimit të aktit juridik, duke analizuar ndryshimet dhe krahasimin tek grupi i trajtimit *ex post*. Vlerësimet prospektive të ndikimit kanë më shumë mundësi të japin rezultate të besueshme të vlerësimit pasi grupet e trajtimit dhe krahasimit identifikohen përpara se të zbatohet akti juridik që vlerësohet. Kështu, vlerësimet prospektive të ndikimit kanë mundësi më të mëdha për të krijuar kundër-fakte të vlefshme.

#### Pyetjet kyçe:

Disa nga pyetjet e përgjithshme që vlerësimi i ndikimit duhet të përpiqet t'u përgjigjet janë:

#### Efektiviteti:

- A është një ndërhyrje e caktuar e aktit juridik efektive, në krahasim me mungesën e aktit juridik?
- Nga çka varet ndryshimi i rezultateve ndërmjet individëve, palëve të interesuara// grupeve të shoqërisë (sektorit ekonomik,) dhe si dallon ky ndryshim me atë që ishte parashikuar?

#### Efikasiteti:

- Kur një akt juridik mund të zbatohet në disa mënyra, cila është mënyra më efektive apo me kosto më të ulët?

#### Ndikimi:

- Cilat janë qëllimet e aktit juridik? A ka pasur ndryshime të observuara, dhe sa mund të thuhet se janë shkaktuar nga akti juridik në krahasim me faktorët e tjerë?
- A ka ndodhur për shkak të aktit juridik ndonjë rezultat që nuk ishte menduar fillimisht? Nëse po, çfarë ka ndodhur dhe sa është i rëndësishëm ndryshimi në fjalë?

<sup>12</sup> Situata që do të ndodhte, po të mos zbatohet ndërhyrja apo akti ligjor.

<sup>13</sup> Eksperimentet natyrore ndodhin kur dy grupe krijohen nga natyra dhe jo nga projektimi i eksperimentit

Për më shumë informacion në lidhje me kryerjen e analizave eksperimentale dhe kuazi-eksperimentale për vlerësimin e ndikimit, ju lutemi merrni parasysh botimet e mëposhtme:

1. Grupi i Bankës Botërore (2016): *Vlerësimi i ndikimit në praktikë*, botimi i dytë <https://www.worldbank.org/en/programs/sief-trust-fund/publication/impact-evaluation-in-practice>.
2. Grupi i Bankës Botërore (2009): *Rruga drejt rezultateve: Projektimi dhe kryerja e vlerësimit efektiv të zhvillimit*, nga Linda G. Morra Imas, Ray C. Rist, <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/2699>.
3. HM Thesari (2011): *Libri Magenta, Udhëzues për Vlerësim*, Londër, [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/879438/HMT\\_Magenta\\_Book.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/879438/HMT_Magenta_Book.pdf).

#### A.4.4. Analiza kosto-përfitimi dhe kosto-efektiviteti

Pasi rezultatet e Vlerësimit të Ndikimit të jenë në dispozicion, ato mund të kombinohen me informacionin mbi kostot që lidhen me zbatimin e aktit juridik për t'ua kryer një Analizë Kosto-Përfitimi (AKP) ose Analizë Kosto-Efektiviteti (AKE).

**Analiza kosto-përfitimi (AKP)** krahason përfitimet dhe kostot që dalin nga zbatimi i aktit juridik. AKP-ja rezulton nga diferenca ndërmjet përfitimeve totale dhe kostove totale (Përfitimet – Kostot). Është një teknikë shumë e vlefshme, pasi llogarit të gjitha efektet (negative dhe pozitive) e aktit juridik. Kjo do të thotë që AKP-ja mund t'ua ofrojë arsyetimin e përgjithshëm të një aktit juridik (“A i tejkalojnë përfitimet kostot?”), si dhe të krahason aktin juridik me lloje të ndryshme të opsioneve që mund të krijojnë rezultate të ngjashme. AKP-të definojnë në terma monetare sa më shumë kosto dhe përfitime të një aktit juridik, duke përfshirë ndikime më të gjera sociale dhe mjedisore (si krimi, ndotja e ajrit, aksidentet e trafikut etj.) aty ku është e mundur.

Sidoqoftë, grupi punues duhet të ketë parasysh edhe të metat e saj: AKP-ja mund të zbatohet vetëm për ndikimet që janë të përcaktuara në sasi dhe të monetizuara (shprehura në para); dhe duhet të shoqërohet me analiza shtesë për të përfshirë edhe çështjet e shpërndarjes.

Një procedurë e plotë e AKP-së bazohet në hapat e mëposhtëm:

1. analiza e llojeve të palëve të interesuara dhe sektorëve, të cilët do të ndikohen nga akti juridik;
2. përcaktimi sasi i atyre që janë prekur - sa firma, sa sektorë, sa individë etj.;
3. identifikimi i kostove dhe përfitimeve për secilën kategori;
4. përcaktimi sasi/monetarizimi i kostove dhe përfitimeve;
5. mbledhja e të gjitha përfitimeve dhe kostove të pritshme në të ardhmen, dhe llogaritja e përfitimeve neto (= vlera përfundimtarë të analizës kosto-përfitimi); dhe, mundësisht,
6. të treguarit se cilët kufinj gabimi ose panjohurie duhet të merren parasysh.

AKP-ja e plotë mund të jetë intensive dhe e vështirë të realizohet. Grupi punues duhet t'ua zbatojë këtë procedurë në mënyrë proporcionale, në varësi të kohës, burimeve dhe disponueshmërisë së të dhënave. Grupi punues duhet t'i deklarojë gjithmonë të gjitha supozimet që janë bërë gjatë përcaktimit të kosotove ose përfitimeve.

Meqenëse kostot dhe përfitimet janë të prirura të ndodhin gjatë shumë viteve dhe në momente të ndryshme kohore, rekomandohet të merren parasysh këto dallime përmes procesit të “zbritjes” apo “skontimit”. Zbritja mundëson krahasimin e drejtpërdrejtë të kostove dhe përfitimeve pavarësisht se në cilën kohë ndodhin ato. Duke shtuar të gjitha përfitimet dhe kostot që lindin gjatë një numri të caktuar vitesh (p.sh. flukset monetare të kostos dhe përfitimeve gjatë periudhës së analizës) dhe duke aplikuar “normën e zbritjes (ose skontimit)”<sup>14</sup> mund të llogaritet një vlerë aktuale e kostove dhe përfitimeve. Vlera aktuale neto (NPV) është shuma e flukseve monetare neto të skontuara gjatë periudhës së analizës.

<sup>14</sup> Formula për faktorin e skontimit në periudhë n: Vlera e ardhshme në periudhën n x = 1/(1 + norma e skontimit)<sup>n</sup>

Për dallim, **Analiza e kosto-efektivitetit (AKE)**, është më e thjeshtë për të kalkuluar. AKE pasqyron një nevojë shumë specifike: maksimizimin e efikasitetit, duke pasur parasysh një qëllim ose cak të deklaruar, ose një kufizim të jashtëm (siç janë kufijtë e buxhetit). Prandaj, kjo teknikë fokusohet vetëm në anën e kostos së ekuacionit. AKE-ja kalkullohet nga formula (Kosto/Efekt). AKE lidh efektet e aktit juridik me koston totale të prodhimit të këtyre efekteve. Kriteri për vlerësim të AKE-së është zakonisht kostoja për njësi e rezultatit të arritur (për shembull, kostoja për vend pune të krijuara ose për nëpunës civil të trajnuar). Për këtë arsye, kjo teknikë mund të aplikohet edhe në lloje të tjera vlerësimi, jo vetëm të Vlerësimit të Ndikimit. Kosto për njësi krahasohet më pas me skenarët ose mundësitë e tjerë që pritet ta japin të njëjtin rezultat, (p.sh. krahasimi i kursimeve të krijuara me zbatimin e aktit juridik).

AKE-ja nuk kërkon që përfitimet të shprehen në formë monetare, megjithatë ajo ka disa mangësi. Së pari, AKE ka tendencë t'i neglizhojë efektet anësore të mundshme pasi përqendrohet në një lloj përfitimi të vetëm. Së dyti, nuk jep rezultat të qartë nëse akti juridik ka siguruar përfitime neto për shoqërinë.

Vlen të theksohet se përmes AKE:

1. llogariten dhe monetarizohen kostot e zbatimit të aktit juridik;
2. analizohet nëse të njëjtat rezultate mund të arrihen me më pak kosto nëse zbatohen qasjet e ndryshme ose nëse mund të ishin arritur më shumë rezultate me të njëjtën kosto duke përdorur qasje ose alternativave të tjera;
3. nxjerren konkludime për efektivitetin e kostos së zbatimit të aktit juridik dhe prezantohen opsionet për ndryshimin/përmirësimin e aktit juridik aty ku është e mundur.

**Zgjedhja ndërmjet AKP dhe AKE:** Tabela më poshtë ilustron dy kriteret përkatëse (qëllimi i politikës dhe mjedisi i të dhënave) për t'i krahasuar respektivisht AKP-në dhe AKE-në. Tabela këshillon se cilën nga të dyja duhet përdorur, duke pasur parasysh kushtet në fjalë.

Tabela A.4.1. Përdorimi i AKP ose AKE?

Metodologjia	Qëllimi i politikës	Mjedisi i të dhënave
Analiza Kosto-Përfitim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• e panjohur</li> <li>• e përcaktuar gjerësisht</li> <li>• skenarët e mundshëm janë ende të hapur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kostot dhe përfitimet të matshme</li> <li>• kompromiset (trade-offs)</li> </ul>
Analiza e kosto-efektivitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• fikse (p.sh. konform kërkesave ligjore; kufizimet buxhetore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përfitimet janë të vështira për t'u llogaritur</li> <li>• niveli përfitimeve nuk është relevante</li> </ul>


Më shumë informacion mbi AKP dhe AKE mund të gjenden duke u konsultuar burimet e mëposhtme:

1. Komisioni Evropian (2021), Kapitulli 8 – Metodologjitë për analizën e ndikimeve në vlerësimet e ndikimit, vlerësimet e tjera dhe kontrollet e përshtatshmërisë, [https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br\\_toolbox\\_-\\_nov\\_2021\\_-\\_chapter\\_8.pdf](https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/br_toolbox_-_nov_2021_-_chapter_8.pdf).
2. Zerbe Jr, R., dhe T. Scott (2015): Të kuptuarit e analizës kosto-përfitim, [https://aisp.upenn.edu/wp-content/uploads/2015/09/0033\\_12\\_SP2\\_Benefit\\_Cost\\_000.pdf](https://aisp.upenn.edu/wp-content/uploads/2015/09/0033_12_SP2_Benefit_Cost_000.pdf).
3. Gines de Rus (2010): Hyrje në analizën kosto-përfitim, Edward Elgar Publishing.
4. Mishan, E.J., and Quah, E. (2014): Analiza kosto-përfitim, Edicioni i 5.

## Shtojca A.5. Metodatat e mblledhjes së të dhënave

Grupi punues mund të përdorë metoda të ndryshme të mblledhjes së të dhënave për t'a mbështetur vlerësimin— shih Figurën A.5.1. Zgjedhja e metodave të ndryshme varet nga (i) çështja që do të ekzaminohet (treguesi i performancës në shqyrtim); (ii) cilësia e informacionit të nevojshëm; (iii) afati kohor i informacionit të nevojshëm; dhe (iv) kostoja për mblledhjen e të dhënave.

Figura A.5.1. Metodatat e mblledhjes së të dhënave: Vështrim i përgjithshëm



Kjo Shrojcë përshkruan shkurtimisht disa metoda të mblledhjes së të dhënave dhe veçoritë e tyre kryesore.

### • Mblledhja e të dhënave me pjesëmarrje

Mblledhja e të dhënave me pjesëmarrje mund të kryhet në forma të ndryshme. Takimet e komunitetit i mundësojnë grupit punues të ndërveprojë me popullatën përkatëse për të kuptuar ndonjë progres të arritur në treguesit kryesorë të performancës. Kjo metodë lejon pjesëmarrjen e gjerë; është mjaft e lirë dhe relativisht e lehtë për t'u organizuar. Megjithatë, pjesëmarrësit në takime mund të mos e përfaqësojnë saktë komunitetin. Për këtë arsye, këto takime mund të plotësohen me metoda më të gjera si faqet interaktive të internetit, panelet dhe juritë e qytetarëve, sondazhet konsultative dhe vlerësimet me pjesëmarrje të komunitetit. Hartëzimi nga ana tjetër mund të përdoret për shembull për mblledhjen e të dhënave hapësinore. (Përndryshe, Google Earth™ mund të përdoret për hartografi). Një shëtitje tërthore është një lloj shëtitjeje që grupi punues mund të bëjë rreth një komuniteti për t'a bërë një observim të ndryshimeve në atë komunitet, rrethinës dhe burimeve, për shembull për të dhënat hapësinore, kushtet e banimit, tregtinë informale në rrugë, praninë dhe natyrën e punës së fëmijëve etj.

### • Analiza e të dhënave administrative dhe të dhënave dytësore

Të dhënat që janë mblledhur tashmë mund të përdoren për t'u përgjigjur pyetjeve të vlerësimit Ex-Post. Qasja dhe analiza e dokumenteve që janë mblledhur tashmë mund të janë të rëndësishme dhe mund të sigurojë të dhëna të pasura për aktin juridik. Këto mund të përfshijnë baza të të dhënave, dosjet e rasteve, raportet e progresit etj. Për më tepër, disa nga të dhënat mund të grumbullohen për shembull nga baza e të dhënave të prodhuara dhe të mblledhura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe nga institucionet tjera qeveritare, administrata publike dhe organizatat zhvillimore.

### Përparësitë dhe sfidat e të dhënave administrative dhe dytësore

**Përparësitë:** Ky lloj i të dhënave është zakonisht më pak i kushtueshëm dhe më i shpejtë për t'u mblledhur në krahasim me mblledhjen e të dhënave primare;

**Sfidat:** Të dhënat mund të mos mbulojnë saktësisht atë që nevojitet, mund të mos jenë të azhurnuara, dhe mund të jetë e vështirë të sigurohet qasja në të dhëna afatgjate.

### • Vëzhgimi

Vëzhgimi mundëson mblledhjen e informacionit të drejtpërdrejtë, të dorës së parë, të sjelljes së vazhdueshme, procesit, ngjarjeve për të ekzaminuar dëshmi fizike për produktet, rezultatet dhe veçanërisht për ndryshimet e sjelljes. Vëzhgimi mund të jetë i strukturuar ose i pastrukturuar. Një qasje e strukturuar nënkupton që, para vëzhgimit, grupi punues përcakton saktësisht se çfarë do të vëzhgohet dhe në cilin interval kohor.<sup>15</sup> Vëzhgimet e pastrukturuar ndodhin kur grupi punues zgjedh metodën e mblledhjes së të dhënave varësisht nga situata, pa ide të paracaktuara ose plan se çfarë të vëzhgojë ose për sa kohë të vëzhgojë.

### Përparësitë dhe Sfidat e Vëzhgimit

**Përparësitë:** Të dhënat mblledhen për sjelljen aktuale dhe jo përmes vetë-raportimeve apo perceptimeve. Është mblledhje e të dhënave në kohë reale (dhe jo retrospektive).

**Sfidat:** Marrja e mostrave, si dhe regjistrimi dhe interpretimi i të dhënave mund të jetë i vështirë. Mblledhja e të dhënave mund të jetë punë intensive.

### • Intervistat (ose intervistat e thelluara)

Intervista është një dialog ndërmjet një intervistuesi dhe një ose më shumë të intervistuarve, kryesisht mbi pyetjet të hapura.<sup>16</sup> Përgjigjet nga intervistat mund të ofrojnë informacion të pasur në lidhje me qëndrimet, opinionet dhe përvojat e njerëzve të prekur nga akti juridik (si për zbatuesit të aktit si për ata që preken ose përfitojnë nga akti juridik). Kjo metodë mund të ofrojë informacion të thelluar sesi akti juridik funksionon në praktikë. Intervistat janë veçanërisht të dobishme kur grupi punues dëshiron të kuptojë më thellë mbi ndryshimin e ndodhur (ose që nuk ka ndodhur) ose t'i kuptojë arsyet pse të intervistuarit kanë pikëpamje të veçanta. Kjo metodë u lejon pjesëmarrësve të shpjegojnë në mënyrë të hapur pikëpamjet, vendimet ose veprimet e tyre. Gjithsesi, duhet pasur parasysh se intervistat janë më të vështira për t'u përfunduar, më të vështira për t'u analizuar dhe më pak efektive kur punohet me një numër të madh njerëzish.

### Përparësitë dhe sfidat e intervistave

**Përparësitë:** Mund të eksplorojë çështje komplekse në thellësi, por edhe të përqendrohet në çështje specifike dhe të mbeten relativisht të shkurtra.

**Sfidat:** Mund të jetë e shtrenjtë, punë intensive dhe kërkon kohë. Gjithashtu, kërkon ndjeshmëri kulturore.

### • Fokus Grupet (ose intervista në grup)

Fokus grupi është një metodologji vlerësimi cilësor në të cilën grupe të vogla njerëzish mblidhen së bashku për të diskutuar tema specifike në shumë detaje, nën drejtimin e një moderatori. Fokus grupet ofrojnë një mundësi për të mblledhur

<sup>15</sup> Vëzhgimet mund të strukturohen duke përdorur një listë kontrolli për të shikuar rastet e ndryshme ose një kronometër për afatin kohor.

<sup>16</sup> Intervistat me pjesëmarrësit kryesorë mund të jenë të strukturuar (një listë e caktuar pyetjesh përdoret me të gjithë të intervistuarit), gjysmë të strukturuar (një listë pyetjesh me fleksibilitet për të hetuar më tej) ose të pastrukturuar (pa listë të caktuar pyetjesh).



informacion për një grup njerëzish mbi qëndrimet, opinionet, perceptimet dhe përvojat e tyre, duke ndërtuar dhe reflektuar mbi idetë e njëri-tjetrit dhe duke sugjeruar një sërë pikëpamjesh dhe propozimesh. Fokus grupet mund të përdoren me një kategori njerëzish që zbatojnë ose ndikohen nga akti juridik. Diskutimi në fokus grupe është shpesh jo-linear (d.m.th. diskutimi nuk përparon në mënyrë logjike nga një fazë ose nivel i zinxhirit të rezultateve në tjetrën). Fokus grupet përdoren për të mbledhur të dhëna mbi ndërveprimin e pjesëmarrësve në grup për të përgjigjur pyetjeve “si” dhe “pse” dhe jo “nëse” dhe “sa” si dhe për reagimet e menjëhershme, kompleksitetin e sjelljeve dhe motivimeve, pikëpamjet mbi tema të ndjeshme etj. Përgjithësisht, fokus grupi përfshin 6-12 persona dhe diskutimet zakonisht zgjasin një deri në dy orë.

#### Përparësitë dhe Sfidat e Fokus Grupeve

**Përparësitë:** Mund të kryhet relativisht shpejt dhe lehtë; mund të marrë më pak kohë të stafit sesa intervistat e thella; si dhe mund të eksplorojnë këndvështrime të ndryshme.

**Sfidat:** Analiza kërkon kohë; pjesëmarrësit mund të mos jenë përfaqësues të popullatës; grupi mund të ndikohet nga moderatorë ose anëtarë dominues të grupit.

#### • Anketat

Anketat janë ideale për të mbledhur të dhëna për një popullatë të madhe rreth perceptimeve, opinionëve dhe ideve të tyre. Anketat e strukturuar parashtrajnë pyetje kryesisht të mbyllura, përgjatë një sërë opsionesh, me ç’rast të anketuarit duhet t’u zgjedhin një ose disa prej tyre. Të gjithë të anketuarve u bëhen saktësisht të njëjtat pyetje në të njëjtën mënyrë dhe u jepen saktësisht të njëjtat alternativa për t’u përgjigjur pyetjeve. Ato janë më pak të dobishme për t’u matur sjelljen, sepse jodomosdo njerëzit bëjnë në të vërtetë atë që thojnë (paragjykim vetë-raportues). Mund të jetë e mundur të përsëriten anketat për të monitoruar ndryshimet në treguesit kryesorë gjatë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së aktit juridik. Në varësi të mënyrës se si është përcaktuar mostra, anketa mund të sigurojë të dhëna që mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë e interesit. Anketat mund të administrohen në një sërë mënyrash, duke përfshirë ballë për ballë, telefon, e-mail dhe media sociale dhe me postë. Secila prej të cilave ka implikime pozitive dhe negative në lidhje me çështje të tilla, si përqindjet e marrjes së përgjigjeve dhe kostoja. Pyetësorët përdoren më shpesh për të mbledhur të dhëna sasiore, por gjithashtu mund të përmbajnë edhe tekst të lirë për mbledhjen e të dhënave cilësore.<sup>17</sup>

#### Gjatë hartimit të anketave, ekzistojnë katër rregulla të arta që janë të dobishme të merren parasysh:

Disa nga pyetjet e përgjithshme që vlerësimi i ndikimit duhet të përpiqet t’u përgjigjet janë:

##### Efektiviteti:

- A mund ta kuptojnë të anketuarit pyetjen – dhe a e kuptojnë ata në të njëjtën mënyrë si grupi punues?
- A janë në gjendje të anketuarit t’i përgjigjen pyetjes?
- A janë ata të gatshëm t’i përgjigjen pyetjes?
- A do të ofrojnë pyetja një përgjigje të besueshme?

*Burimi: HM Thesari (2020): Libri Magenta, Udhëzues për Vlerësim*

<sup>17</sup> Për më shumë informacion rreth realigimit së anketave, ju lutemi shihni: Grupi i Bankës Botërore (2009): Rruga drejt rezultateve: Projektimi dhe Kryerja e Vlerësimit të Zhvillimit Efektiv nga Linda G. Morra Imas, Ray C. Rist (kapitulli 9)

#### • Gjykimi i ekspertit

Nëpërmjet kësaj metode, grupi punues angazhon ekspertët si burim informacioni ose opinionit për progresin e arritur rreth treguesit të performancës. Gjykimi mund të merret individualisht nga një ekspert i vetëm ose nga një grup ekspertësh. Një grup ekspertësh mund të kryejë metoda shtesë të mbledhjes së të dhënave, të tilla si rishikime ose vëzhgime në një spital ose në shkollë. Gjykimi i ekspertit mund të përdorë kritere dhe procedura të paracaktuara profesionale, ose mund të bëhet *ad hoc*. Kjo metodë është veçanërisht e dobishme në vlerësimet e shpejta.

#### • Teknika Delphi

Teknika Delphi u mundëson ekspertëve të angazhohen në dialog dhe të arrijnë konsensus përmes një procesi përsëritës. Ekspertëve u bëhen pyetje specifike; përgjigjet e tyre i dërgohen një burimi qendror, përmbledhen dhe u kthehen ekspertëve. Ekspertët pastaj e komentojnë përmbledhjen. Ata janë të lirë të sfidojnë pikëpamje të veçanta ose të shtojnë këndvështrime të reja duke ofruar informacion shtesë. Pasi që askush nuk e di se çfarë thotë tjetri/a, konflikti mes tyre shmanget. Teknika Delphi nxjerr informacion dhe gjykime nga pjesëmarrësit mbi progresin e arritur, por pa i vënë ata ballë për ballë.

#### Shtojca A.6. “Matrica e vlerësimit”

Faza në logjikën e ndërhyrjes	Çështje për t’u vlerësuar	Treguesi	Metoda e mbledhjes së të dhënave/ Burimi i të dhënave	Vlera bazë <sup>18</sup>	Vlera aktuale
Të dhënat					
Aktivitetet					
Produkti					
Rezultatet fillestare (sjellja)					
Rezultatet e ndërmjetme (performanca)					
Ndikimet					

<sup>18</sup> Mundësisht para hyrjes së aktit juridik

## Shtojca A.7. Listat e kontrollit të cilësisë

Kontrolli i cilësisë rrit besimin dhe besueshmërinë e analizës. Kjo Shtojcë i lejon vlerësuesit ta kontrollojë cilësinë e të dhënave të përdorura për vlerësimin *Ex-Post*, si dhe cilësinë e përgjithshme të vlerësimit *Ex-Post*.

### A.7.1. Cilësia e të dhënave

Cilësia e të dhënave vlen për të gjithë Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave, nga burimi deri te përdorimi i të dhënave. Vlerësuesi mund t'a kontrollojë cilësinë e të dhënave duke përdorur një sërë kriteresh, sipas tabelës në vijim:

Treguesi	Rishikues(t)	Data e rishikimit	Burimi i të dhënave
<b>Kriteri</b>	<b>Përkufizimi</b>	<b>Po / Jo</b>	<b>Shpjegim</b>
Vlefshmëria	<i>A paraqesin të dhënat në mënyrë të duhur rezultatin e synuar? Disa çështje që duhen marrë parasysh janë: -- <b>Vlefshmëria e drejtpërdrejtë.</b> A do të pajtohej një i huaj ose një ekspert i fushës që treguesi është një masë e vlefshme dhe logjike për rezultatin e deklaruar? -- <b>Atribuimi.</b> A e mat treguesi kontributin e bërë nga akti juridik? -- <b>Gabim në matje.</b> A ka ndonjë gabim në matje që mund të ndikojë në të dhëna? Si gabimi i mostrës ashtu edhe gabimi i përpunimit të dhënave duhet të rishikohen.</i>		
Besueshmëria	<i>A pasqyrojnë të dhënat procese të qëndrueshme të mbledhjes së të dhënave?</i>		
Preciziteti	<i>A janë të dhënat mjaftueshëm të sakta për të paraqitur një pamje të drejtë të performancës dhe për të mundësuar vendimet e menaxhmentit në nivelet e duhura?</i>		
Kohëzgjatja	<i>A janë zhvilluar të dhënat brenda një afati kohor të mjaftueshm për të ndikuar në vendimet e menaxhmentit?</i>		
Integriteti	<i>A ka mekanizma të vendosur për t'i reduktuar gabimet e thjeshta në transkriptim të të dhënave të mbledhura, si dhe gjatë analizës dhe raportimit të dhënave?</i>		

Çështjet kryesore dhe rekomandimet (përmbledhje):

## Shtojca A.8. Vlerësimi Ex-Post i ilustruar: “Ligji për shërbime këshilluese për zhvillimin rural”

Kjo pjesë e Manulit ofron një shembull hipotetik por konkret se si udhëzimet e dhëna në këtë manual mund të zbatohen në një akt juridik të vetëm. Le të supozojmë se objekti i vlerësimit tonë është *ligji që përcakton standardet dhe kërkesat minimale për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve këshilluese dhe aktiviteteteve trajnuese për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë.*

### Nenet kyçe të LIGJIT NR. 04 / L-074 - PËR SHËRBIME KËSHILLUESE PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL:

- Qëllimi i përgjithshëm i ligjit: Ngritja e nivelit të përgjithshëm të njohurive të fermerëve, ofrimi i trajnimeve për menaxhimin e fermës, rritja e të ardhurave të fermës, trajnimi i fermerëve për përdorimin e teknologjive të reja etj.. (neni 1)
- Organizimi dhe zbatimi i aktiviteteteve të shërbimeve këshilluese për bujqësinë dhe zhvillimin rural (neni 2)
- Organizimi i shërbimeve këshilluese publike (në nivel qendror dhe lokal) (nenet 5-7))
- Shërbimet Private të Këshillimit (përmes një personi fizik dhe juridik (nenet 8-10))
- Metodat e ofrimit të shërbimit këshillues (nenet 11-14)
- Raportimi i të gjithë ofruesve të shërbimeve këshilluese në Ministri (neni 16)
- Certifikim për ofrimin e shërbimeve këshilluese private dhe publike (nën kushtet e caktuara për 5 vjet) (neni 17)
- Leja për persona juridikë (nën kushtet e caktuara për 5 vjet) (neni 18)
- Regjistri i personave juridikë dhe fizikë si këshilltarë për shërbime këshilluese – (Nenet 19-20)
- Programi i trajnimit dhe plani i trajnimit për këshilltarët (nenet 21-22)

Në këtë rast, “akti juridik” që vlerësohet është i tërë Ligji 04 / L-074. Në këtë drejt, vlerësimi Ex-Post do të ndjekë hapat e mëposhtëm:

### HAPI 1: Zhvillimi i zinxhirit të rezultateve

Së pari, duhet të zhvillohet zinxhiri vijues i rezultateve mbi të cilin bazohet zbatimi i suksesshëm i ligjit. Tabela A.8.1 propozon një zinxhir të mundshëm të rezultateve.

Tabela A.8.1. Ligji për shërbimet këshilluese: Zinxhiri i Rezultateve

<b>INPUTET(-FAKTORËT)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për hartimin e programit të trajnimit (përfshirë përgjydhjen, formimin dhe certifikimin e trajnerëve dhe këshilltarëve)</li> <li>• Burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për të promovuar, organizuar dhe ofruar trajnimin për fermerët</li> </ul>
<b>AKTIVITETET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi i programit të trajnimit për këshilltarët</li> <li>• Certifikimi, regjistrimi dhe licencimi i këshilltarëve/trajnuesve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve këshilluese dhe trajnimi për fermerët</li> </ul>
<b>PRODUKTI</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e nivelit të njohurive të fermerëve (ata që ndjekin trajnimet)</li> </ul>

<b>REZULTATET FILLESTARE (sjellja)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aplikimi i njohurive të reja, metodave e prodhimit, teknologjitë etj.</li> </ul>
<b>REZULTATET E NDËRMJETME (performanca)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e nivelit të prodhimit (dhe/ose produktivitetit) në ferma</li> </ul>
<b>NDIKIMET</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ardhura më të larta të fermerëve</li> <li>• Punësimi më i lartë (sezonal dhe me orar të plotë)</li> </ul>

### HAPI 2: Zgjedhja e llojit të vlerësimit

Hapi tjetër është të vendoset për llojin e vlerësimit. Ligji i shqyrtuar në shembullin tonë lejon në parim kryerjen e të tri llojeve të vlerësimit. Konkretisht:

- **Vlerësimi i Zbatimit dhe Pajtueshmërisë:** Siç dihet, ky vlerësim ka të bëjë me vlerësimin e zbatimit (ose jo) të kërkesave ligjore të përcaktuara në ligj. Prandaj, ai përqendrohet në inputet dhe aktivitetet e zinxhirit të rezultateve siç është hartuar në Hapin 1.

Në rastin e vlerësimit *Ex-Post* të këtij ligji, kryerja e një Vlerësimi të Zbatimit dhe Pajtueshmërisë do të nënkuptonte mbledhjen e të dhënave në lidhje me (a) miratimin e rregulloreve të nevojshme zbatuese (nëse parashikohen me ligj); dhe (b) hartimin, organizimin dhe ofrimin e trajnimeve për këshilltarët (me certifikimin dhe licencimin përkatës) si dhe për fermerët. Pas shqyrtimit të këtyre treguesve të performancës, duhet të vlerësohet nëse është zbatuar në të vërtetë është në përputhje me dhe e pasqyron atë që ishte parashikuar në dispozitat e ligjit, nëse dispozitat përkatëse janë zbatuar në kohë dhe plotësisht dhe cilat dispozita nuk janë zbatuar - dhe pse. Duhet të vlerësohet edhe shkalla deri në të cilën moszbatimi i ndonjërit prej aktiviteteve ka rrezikuar realizimin e rezultateve të synuara.

- **Vlerësimi i Performancës:** Vlerësimi i Performancës kryhet vetëm kur dihet se të gjitha aktivitetet e planifikuara janë realizuar. (pra, ato të cilat i dimë pas përfundimit të vlerësimit të Zbatimit dhe Pajtueshmërisë.) Duhet pasur parasysh se Vlerësimi i Performancës e zgjeron fushën e analizës në realizimin e produkteve dhe nëse produktet kanë shkaktuar apo jo ndryshimin e pritur në sjelljen e grupeve të synuara (rezultatet fillestare) – ndoshta edhe më tej deri tek ndikimet përfundimtare.

Kështu që, në shembullin e dhënë, hapi kritik do të ishte konstatimi nëse fermerët që kanë ndjekur trajnimet ose shërbimet e këshillimit të organizuara në kuadër të aktiviteteve të rregulluara nga ligji që vlerësohet, kanë marrë në fakt më shumë njohuri për teknikat dhe metodat e reja bujqësore se sa që kanë pasur. Nëse fermerët kanë fituar më shumë njohuri, hapi tjetër i vlerësimit do të ishte të shikohet nëse fermerët i kanë aplikuar ato teknika dhe metodat e reja në fushat e tyre.

Duket qartë se Vlerësimi i Performancës nënkupton dy gjëra:

- fillimisht, demonstrimin, duke u bazuar në dëshmi objektive, të ekzistencës së mekanizmave shkak-pasojë që kemi modeluar në zinxhirin e rezultateve; dhe

- së dyti, kalimi i një periudhe të caktuar kohore para se vlerësimi të kryhet që nga hyrja në fuqi e ligjit, sepse (1) duhet të lihet koha teknike që të miratohen masat zbatuese (nëse kërkohet), (2) të organizohen dhe të zhvillohen trajnimet (në fillim të këshilltarëve, të cilët gjithashtu duhet të certifikohen dhe më pas fermerëve); dhe (3) që këta të fundit t'i përdorin njohuritë e marra.

Vlerësimi i performancës mund të shtrihet edhe në rezultateve të ndërmjetme dhe ndikimeve përfundimtare, me kusht që të gjinden dëshmi për këtë. Konkretisht, kjo do të nënkuptonte zgjerimin e fushës së vlerësimit për të përcaktuar nëse ka ndryshime të mëtejme nga aplikimi i metodave dhe njohurive të reja të prodhimit. Duke u mbështetur në hapin e mëparshëm, duhet shqyrtuar nëse fermerët që kanë aplikuar njohuritë, teknikat dhe mjetet e reja në fushat e tyre, ka

ndikuar në një rritje të produktivitetit të përgjithshëm (dhe/ose prodhimit) të fermave të tyre - dhe përfundimisht nëse të njëjtit kanë gjeneuar të ardhura më të larta. Gjatë kryerjes së vlerësimit të performancës, duhet të vlerësohen mekanizmat e shkak-pasojë: ligji që është objekt vlerësimi mund të jetë i vetmi faktor që prodhon efekte pozitive në të ardhurat e fermerëve, ose mund të jetë vetëm njëri nga faktorët (ose bashkë-përcaktues) që prodhon efekte pozitive në të ardhurat e fermerëve. Po ashtu, ka mundësi që ligji nuk ka prodhuar asnjë efekt pozitiv në të ardhurat e fermerëve.

- **Vlerësimi i Ndikimit:** Duhet të zgjedhet ky lloj vlerësimi, nëse shtrohet nevoja për t'a vërtetuar se përdorimi i teknikave dhe mjeteve të reja bujqësore lidhet vetëm me fermerët që kanë ndjekur trajnimin. Nëse evidentohet një lidhje e qartë e drejtpërdrejtë dhe shkakësore (shkak-pasojë) ndërmjet trajnimit dhe përdorimit të metodave të reja të prodhimit, atëherë –do të jemi në gjendje t'ia "atribuojmë" ndryshimin ligjit që është objekt i vlerësimit. Prandaj, për vlerësimin e ndikimit, duhet të merren parasysh dy grupe: fermerët që kanë ndjekur trajnimin dhe fermerët që nuk e kanë ndjekur trajnimin (ky i fundit është grupi i "kontrollit").

Nëse do të konstatohet se fermerët e tjerë i zbatojnë teknikat dhe mjetet e reja, edhe nëse nuk e kanë ndjekur trajnimin, atëherë ligji është vetëm një nga faktorët që e ka shkaktuar një ndryshim të tillë në fermat kosovare.

E njëjta logjikë do të aplikohet për segmentet e mëvonshme të zinxhirit të rezultateve:

- Së pari, duhet të vlerësohet nëse ka rritje të të ardhurave të atyre fermerëve që e kanë ndjekur trajnimin dhe që më pas i kanë aplikuar teknikat e reja. Nëse nuk është kështu, atëherë ligji nuk e ka përmbushur qëllimin e tij, dhe duhet të shqyrtohet pse nuk ka ndodhur kjo. Nëse me të vërtetë fermerët e trajnuar kanë pasur rritje të të ardhurave, atëherë duhet të sigurohet që të ardhurat e tilla më të larta të jenë rezultat i aplikimit të teknikave dhe mjeteve të reja të mësuara gjatë trajnimit – dhe jo, për shembull, rezultat i ndryshimeve në çmimet e produkteve bujqësore ose për shkak të kushteve të vështira të motit;

- së dyti, duhet të analizohet se çfarë ka ndodhur me fermerët që nuk kanë marrë pjesë në trajnim (grupi i kontrollit). Nëse gjendja e tyre financiare nuk ka ndryshuar, atëherë trajnimi ka të ngjarë të ketë luajtur një rol të madh në përmirësimin e situatës së fermerëve duke aplikuar njohuritë e reja të mësuara gjatë trajnimit. Nëse edhe fermerët e tjerë kanë pasur të ardhura më të larta gjatë së njëjtës periudhë, atëherë trajnimi nuk është shkaku i vetëm – dhe në fakt mund të mos jetë as shkak i rëndësishëm i rritjes së të ardhurave. Në këtë rast, do të duhet të analizohet pse fermerët në Kosovë (të trajnuar apo jo) kanë pasur rritje në të ardhurat e tyre dhe përfundimisht të përcaktohet nëse ligji është efektiv (dhe relevant) apo jo.

### HAPI 3: Përcaktimi i kriterëve dhe pyetjeve të vlerësimit

Pyetjet e vlerësimit formulohen në atë mënyrë që pasqyrojnë më së miri qëllimet kryesore të vlerësimit, duke pasur parasysh burimet në dispozicion dhe afatin kohorë në të cilën bëhet Vlerësimi *Ex-Post*. Ndonjëherë, pyetjet duhet të përshtaten apo edhe të zgjerohen dhe të shtohen gjatë kryerjes së vlerësimit, sepse provat e reja mund të ri-drejtojnë vlerësimin.

Në vijim të tabelës 1. në Manual, nëse zgjedhim një Vlerësim të Zbatimit dhe të Pajtueshmërisë, mund të referohet në kriteret e "Pajtueshmërisë" dhe "Efektivitetit". Prandaj, pyetjet e mundshme të vlerësimit për ligjin përkatës për shërbimet këshilluese për fermerët mund të jenë:

- A kërkon ligji për shërbimet këshillimore miratimin e akteve nënligjore? Nëse po, a janë miratuar ato? Nëse jo, pse?
- Sa buxhet është lënë në dispozicion për organizimin dhe realizimin e programeve të trajnimit për këshilltarët dhe fermerët,
- respektivisht – dhe sa është disbursuar? Pse nuk është shpenzuar e gjitha / apo pse është tejkaluar buxheti?
- Sa trajnime kanë qenë të planifikuara dhe sa janë organizuar?
- Sa këshilltarë/fermerë (përkatësisht) janë trajnuar? Sa kanë qenë të certifikuar/diplomuar (përkatësisht)?

Llojet e tjera të vlerësimit mundësojnë analizën e kriterëve shtesë. Pyetjet e vlerësimit do të ndryshojnë sipas segmentit të zinxhirit të rezultateve të cilit i referohen. Tabela A.8.2. më poshtë jep disa shembuj.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Në këtë shembull, supozohet se si ligji për shërbimet këshilluese ashtu edhe masat e marra për zbatimin e tij janë të ligjshme dhe të vlefshme. Prandaj, Tabela A.8.2. nuk e merr parasysh "kriterin e ligjshmërisë" në mënyrë të hapur.



Tabela A.8.2. Ligji për shërbimet këshilluese: Formulimi i pyetjeve të vlerësimit

Kriteret	Lidhur me Produktin (përvetësimi i njohurive të reja)	Lidhur me rezultatet fillestare (aplikimi i teknikave/mjeteve të reja)	Lidhur me rezultatet e ndërmjetme (rritje e prodhimit / produktivitetit)	Lidhur me Ndikimet (të ardhura më të larta)
Efektiviteti	Sa pjesëmarrës në trajnime e kanë kaluar testin, duke treguar se kanë fituar njohuri/aftësi të reja?	Sa nga fermerët që e kanë kryer trajnimin, i kanë aplikuar në fakt teknikat e reja? Sa jo - pse?	A është rritur prodhimi në fermat e fermerëve që e kanë kryer trajnimin gjatë periudhës së vlerësimit?	A janë rritur të ardhurat mesatare të fermerëve që kanë kryer trajnimin?
Ndikimi	---	A i aplikojnë fermerët e patrajnuar teknikat e reja?  Nëse po, pse?	A është rritur prodhimi në ferma të tjera tek fermerët e patrajnuar në të njëjtën periudhë?	A janë rritur të ardhurat mesatare të fermerëve të patrajnuar? Sa (krahasuar me fermerët e trajnuar)?
Efikasiteti	Duke marrë parasysh koston e organizimit të trajnimeve, sa fermerë kanë përfunduar trajnimet me sukses?  A ka mënyra më të mira për të arritur një performancë më të mirë?	---	Duke marrë parasysh koston e trajnimeve, cili është raporti kosto-përfitim që ka rezultuar nga rritja e prodhimit në fermat e fermerëve?  A është ky raport i arsyeshëm në krahasim me qasjet e tjera të politikave?	Sa është kostoja financiare (nga buxheti i rritjes së të ardhurave mesatare të një fermieri të trajnuar për 50 euro?
Qëndrueshmëria	---	Sa trajnime duhet të organizohen, për të siguruar një rritje të vazhdueshme të përdorimit të teknikave të reja?  A mund të bëhen të zakonshme këto dinamika (pa trajnime)?	---	Në çfarë mase ka kontribuar ligji në përmbushjen e qëllimeve zhvillimore të qëndrueshme përkatëse kombëtare?

Koherenca	---	---	A ka programe apo ligje të tjera në fuqi për ta nxitur prodhimin bujqësor?  A i plotëson / zëvendëson / ndikon negativisht ky ligj në ato masa?	Si është koordinuar përkrahja ekonomike për fermerët kosovarë?  Si përshtatet ky ligj në politikën gjithëpërfshirëse të qeverisë për zhvillimin rural?
Rëndësia / dobia	A ka ende nevojë për të ngritur njohuritë e fermerëve?	---	A ka ende nevojë për ta rritur prodhimin e përgjithshëm bujqësor të fermerëve nëpërmjet përdorimit të teknikave të reja?	Cili është kontributi i ligjit në nxitjen e mirëqenies ekonomike të fermerëve kosovarë? (krahasuar me instrumentet e tjera)
Shpërndarja	---	A janë përfshirë grupet e caktuara në trajnime me sukses (p.sh. fermerët në zona të thella malore/zona të largëta etj.)?	A kanë përjetuar veçanërisht fermerët e synuar një rritje të prodhimit / produktivitetit?	A është rritur veçanërisht niveli i të ardhurave të fermerëve të synuar?

#### HAPI 4: Përcaktimi i treguesve të performancës

Hapi tjetër është të gjendet mënyra se si të matet dhe shprehet informacioni në lidhje me pyetjet e vlerësimit. Ky është funksioni i treguesve të performancës. Për çdo hap të zinxhirit të rezultatit, duhet të identifikohen llojet e të dhënave të nevojshme për t'ua përcaktuar gjendjen aktuale të situatës.

Duhet të zgjedhen ata tregues që lejojnë trajtimin e pyetjeve përkatëse të vlerësimit. Tabela A.8.3. ("Matrica e Vlerësimit" në HAPIN 6.) rendit disa tregues të mundshëm të performancës në lidhje me ligjin për shërbimet këshilluese për fermerët në Kosovë.

#### HAPI 5: Identifikimi i kërkesave të të dhënave / mbledhjes së të dhënave dhe metodave të konsultimit

Si do të mbledhen të dhënat e nevojshme për treguesit tanë? Kjo lidhet ngushtë me përkufizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave, të përshkruara në Shtojcën A.5.

Në shembullin e cekur më lartë, burimi më i lehtë dhe më i drejtpërdrejtë i të dhënave për shumicën e treguesve të performancës të paraqitur në tabelën A.8.3. janë bazat e të dhënave zyrtare dhe të dhënave administrative, duke përfshirë për shembull rezultatit e testeve të kryera para dhe pas trajnimeve.

Duhet të planifikohen anketa ose fokus grupe me këshilltarët për të diskutuar në lidhje me kërkesat e certifikimit dhe licencimit dhe programin e trajnimit që u ofrohet atyre, me synimin për të marrë komentet dhe vlerësuar nëse janë të

kënaqur me të. Nëse do të vendoset për anketa apo fokus grupe (e cila është më pak të kushtueshme dhe më pak intensive) kjo varet nga numri i këshilltarëve që janë certifikuar.

**Anketa përfaqësuese** duhet të organizohet edhe në lidhje me treguesit e tjerë të performancës, siç janë për nivelin e prodhimit dhe nivelin e të ardhurave të fermerëve të trajnuar; nëse kanë aplikuar metoda të reja prodhimi; dhe niveli i kënaqshmërisë së tyre me trajnimin ose këshillat e marra.

Nëse ndiqen qasjet e atribuimit, dhe kryhet Vlerësimi i Ndikimit, duhet të parashihet mbledhja e të dhënave për grupet e krahasimit për të përcaktuar kundër-faktet përmes analizës statistikore të të dhënave sasiore.

Kur bëhet fjalë për kontaktimin e palëve përkatëse të interesit, duhet të kemi parasysh se palë të ndryshme janë të përfshirë/ndikuar nga zbatimi i ligjit që vlerësohet:

- **Fermerët që janë anëtarë të organizatave kombëtare ose rajonale** ose fermerët që menaxhojnë ferma më të mëdha ka mundësi të jenë më të dukshëm, më të hapur dhe më të fuqishëm në raportimin e qëndrimeve të tyre politike. Për shkak të peshës relative të këtij grupi në sektorin e bujqësisë, është thelbësor angazhimi i tyre nëse objektivi i ligjit është rritja e produktivitetit, prodhimit bujqësor dhe të ardhurave të fermerëve. Ndikimet e çdo nisme të zbatuar në këtë aspekt duhet të jenë të dukshme për këtë grup. Takimet e drejtpërdrejta me organizatat dhe fokus grupet janë forma të duhura të vlerësimit në këtë rast.
- **Fermerët aktivë në zona të largëta dhe në parcela më të vogla**, përkundrazi, ka gjasa të jenë jo vetëm më pak të organizuar, por edhe më pak të informuar mbi nismat e ndërmarra nga qeveria dhe mundësitë e për angazhimit e tyre. Megjithatë, këta fermerë të vegjël janë gjithësi palë kryesore të interesit, sepse çdo përmirësim në produktivitetin bujqësor është gjithashtu (ose edhe veçanërisht) i dobishëm për fermat me të ardhura më të ulëta. Në të njëjtën kohë, këshillimet përmes internetit ose përdorimi i mediave sociale mund të jenë metoda joefektive, sepse gjasat mund të jenë të vogla që fermerë të tillë të jenë mjaft të njohur me teknologjitë dhe mjetet e reja të informacionit. Prandaj, duhet të ndërmerren hapa aktivë në mënyrë që “të mos harrohet/neglizhohet përshtirja e grupeve të interesit,” për shembull duke organizuar intervista dhe takime individuale edhe me fermerët e vegjël.
- Sektorë të ndryshëm të **agrobiznesit**, si industria e përpunimit, industria e inputeve bujqësore etj., prirjen të kenë kapacitete të larta për të mobilizuar interesa dhe prova për të mbështetur vlerësimin e ligjit. Ata janë mbase më pak të prekur nga masat sepse shërbimet këshilluese ose trajnimet specifike për fermerët (për shembull trajnimi i dedikuar për një varietet të ri të farës për t'u mbjellë, ose ushqimi për t'u përdorur) mund të mos ketë pasoja të drejtpërdrejta në qarkullimin e mallrave të industrisë sesa për shembull, masat e politikës tregtare ose vendimet fiskale. Megjithatë, trajnimet dhe këshillimet mund të çojë në një rritje (të konsiderueshme) të shitjes së produkteve të tyre. Megjithatë, për shkak të njohurive dhe rolit të tyre të drejtpërdrejtë për suksesin e aktit juridik, duhet të konsultohet edhe industria e agrobiznesit. Industria mund të ketë interes për t'a lehtësuar zbatimin më të mirë të trajnimeve ose futjen e teknikave dhe mjeteve të reja, nëse vlerësimi do të konsiderohej joefikas në këtë aspekt.
- **Konsumatorët** mund të jetë një burim tjetër i rëndësishëm i dëshmive dhe informacionit mbi ndikimin e krijuar nga shërbimet këshilluese dhe trajnimet e ofruara për fermerët. Për shembull, ata mund të kenë mendime mbi ndikimin më të gjerë që mund t'a kenë krijuar teknikat e reja bujqësore të përdorura sa i përket ndryshimit në disponueshmërinë, cilësinë apo çmimin e produkteve, etj. Megjithatë, këta nuk janë tregues që pasqyrojnë qëllimin parësor të ligjit. Për këtë arsye, mund të jetë e mjaftueshme që në përgjithësi t'u ofrohet mundësia konsumatorëve për të shprehur mendimin e tyre, për shembull duke nisur një anketë (perceptimi) në internet ose duke krijuar platforma të mediave sociale.

#### HAPI 6: Përpunimi i “Matricës së Vlerësimit”

Duke u bazuar në modelin e përshkruar në Shtojcën A.6., Tabela A.8.3 paraqet një Matricë të mundshme për vlerësimin *Ex-Post*.

**Tabela A.8.3.** Ligji Nr. 04/L-074 për shërbimet këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: “Matrica e vlerësimit”

Faza në zinxhirin e rezultatit	Çështje për t'u vlerësuar	Treguesi	Metoda e mbledhjes së të dhënave Burimi i të dhënave
Inputet	Nxjerrja e akteve nënligjore	Përqindja (%) e akteve nënligjore të nxjerra	Rishikimi administrativ
	Burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për hartimin e programit të trajnimit për këshilltarët (trajnerët)	Shuma e buxhetit të shpenzuar për trajnimin e këshilltarëve (trajnerëve) Numri i nëpunësve civilë të angazhuar (dhe kostoja e tyre) për zhvillimin dhe organizimin e trajnimeve për këshilltarët (trajnerët)	Të dhënat administrative Të dhënat administrative (Anketë ose intervista)
	Burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për certifikimin dhe licencimin e këshilltarëve (trajnerëve)	Shuma e buxhetit të shpenzuar për certifikimin dhe licencimin e këshilltarëve (trajnerëve) Numri i nëpunësve civilë të angazhuar (dhe kostoja e tyre) për certifikim dhe licencim	Të dhënat administrative Të dhënat administrative
	Burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për trajnimin e fermerëve	Shuma e buxhetit të shpenzuar për trajnimin e fermerëve Numri i këshilltarëve publikë të angazhuar (dhe kostoja e tyre) për trajnimin e fermerëve	Të dhënat administrative Të dhënat administrative (Anketë ose intervista)

	Ofrimi i programit të trajnimit për këshilltarët (trajnerët)	Numri i këshilltarëve të trajnuar Llojet e trajnimeve të ofruara Niveli i kënaqësisë së këshilltarëve Kostoja për trajnim	Të dhënat administrative Të dhënat administrative Anketa Të dhënat administrative
Aktivitetet	Certifikimi, regjistrimi dhe licencimi i këshilltarëve/trajnuësve	Numri i këshilltarëve privatë dhe publikë të certifikuar Numri i kompanive këshillimore të licencuara Niveli i kënaqshmërisë së kërkesave për certifikim/licencë nga këshilltarët Kostoja për certifikim dhe licencim	Të dhënat administrative Të dhënat administrative Anketa Të dhënat administrative
	Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimi për fermerët	Numri i fermerëve të këshilluar/trajnuar Llojet e trajnimeve/këshillave të ofruara Niveli i kënaqshmërisë së fermerëve Kostoja për trajnimin e një fermieri	Të dhënat administrative Të dhënat administrative Anketa ose fokus grupe Të dhënat administrative
Produkti	Rritja e nivelit të njohurive dhe aftësive të fermerëve (që e ndjekin trajnimin)	Numri (ose %) i fermerëve me njohuri/aftësi për metodat e reja të prodhimit Llojet e njohurive/aftësive të reja të fituara	Testi para dhe pas trajnimit
Regullatatet fillestare (sjellja)	Aplikimi i njohurive të reja, metodat e prodhimit, teknologjitë etj.	Numri (ose %) i fermerëve që aplikojnë metodat e reja të prodhimit	Vëzhgimi
Regullatatet e ndërmjetme (performanca)	Rritja e nivelit të prodhimit në ferma	Niveli (vëllimi) i prodhimit të fermerëve të trajnuar (kundrejt fermerëve të patrajnuar)	Anketa
Ndikimet	Rritja e të ardhurave të fermerëve	Niveli i të ardhurave të fermerëve të trajnuar (në krahasim me fermerët e patrajnuar)	Anketa
	Rritja e punësimit (sezonal dhe me orar të plotë)	Numri i vendeve të punës (sezonale dhe me orar të plotë) të krijuara nga fermerët e trajnuar dhe pagat e tyre mesatare	Anketa

Vlerësimi i Ex-Post i aktit juridik ka edhe këto detyra shtesë:

#### *Kontrollimi i vlefshmërisë së të dhënave*

Një shembull i aplikimit të testit të vlefshmërisë së të dhënave mund të jetë:

- **Cilësia e të dhënave – Besueshmëria:** Supozim: treguesi është “Rritja e vëllimit të mallrave bujqësore të shitura nga fermerët”. Për t’a matur vëllimin e mallrave bujqësore të shitura në treg përdoret një peshore. Por peshorja nuk është kalibruar siç duhet. Për shkak të kësaj, peshorja jep të dhëna jo të besueshme dhe është e vështirë për t’u përcaktuar nëse ndryshimet në të dhëna reflektojnë vërtet ndryshime në vëllimin e shitur.
- **Cilësia e të dhënave - Saktësia:** Niveli i të ardhurave të fituara nga fermerët është 100 euro/muaj. Të dhënat tregojnë se pas disa vitesh kjo është rritur në 300 euro/muaj për fermerët që kanë përfituar nga shërbimet këshilluese të ofruara nga qeveria. Në këtë rast, një gabim matjeje prej 10% (- 30 EUR / muaj) do të ishte në thelb i parëndësishëm. Nuk është e rëndësishme të dihet saktësisht nëse të ardhurat janë 270 apo 330 euro. Një nivel më pak i saktë detajesh është ende i mjaftueshëm për të qenë të sigurt në madhësinë e ndryshimit. Konsideroni një skenar alternativ. Nëse të dhënat e dyta janë 110 EUR / muaj, me një gabim matjeje prej 10 përqind (- 11 EUR) do të ishte plotësisht i papranueshëm sepse do të përfaqësonte të gjithë ndryshimin e dukshëm në të dhëna.





